

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2021



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS**

RAPORTI I VITIT 2021



**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**



Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	4
Parathënie	6
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	8
Masat e KOVID-19	18
DHOMAT	20
1. Aktivitetet gjyqësore	21
2. Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve	29
3. Aktivitetet e jashtme	30
MARRËDHËNIET ME JASHTË	32
ZYRA ADMINISTRATIVE	36
1. Kabineti i Administratores	41
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	42
2.1. Marrëdhëniet me mediat	43
2.2. Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim	46
2.3. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjeti i Informimit të Gjykatës	47
2.4. Informacioni publik mbi DHSK-në	49
3. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	50
4. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	52
4.1. Njësia për Administrimin e Gjykatës	52
4.2. Njësia e Përkthimit	53
4.3. Zyra e Mbrojtjes	53
4.4. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	54
4.5. Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	55
4.6. Njësia e Paraburgimit	56
5. Seksioni i Administratës	57
5.1. Njësia e Burimeve Njerëzore	58
5.2. Njësia e Teknologjisë së Informacionit	60
5.3. Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	61
5.4. Njësia e Sigurisë	62
5.5. Njësia e Financave dhe Buxhetit	63
5.6. Njësia e Prokurimit	64
6. Zyra e Auditimit	65
INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS	66
1. Mjedis pune i sigurt dhe gjithëpërfshirës	67
2. Personi i kontaktit për çështjet gjinore	69
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	73
1. Parathënie	74
2. Zbatimi i mandatit	75
3. ZPS-ja	79
4. Kuadri udhëheqës i Prokurorisë	80
5. Ekipet e Prokurorisë	83

Dhomat e Specializuara të Kosovës



Është kënaqësi për ne t'ju paraqesim raportin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) për vitin 2021. Ndonëse, pandemia e shkaktuar nga KOVID-19 mbeti vështirësi e vazhdueshme gjatë tërë vitit të kaluar, DHSK-ja megjithatë vazhdoi të ketë arritje të rëndësishme. Pas arrestimit të edhe një të akuzuari në mars të vitit 2021, aktualisht 8 të akuzuar gjithsej mbahen në ndalim të DHSK-së, të cilët akuzohen për vepra penale dhe shkelje të pretenduara që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së në katër çështje gjyqësore të ndara. Nga këto katër çështje, dy kanë kaluar në gjykim dhe dy janë ende në fazën e procedurës paraprake. Këto arritje të jashtëzakonshme, të ndërmarra në mënyrë efektive, nuk do të ishin të mundura pa përkushtimin dhe profesionalizimin e gjykatësve të DHSK-së dhe të të gjithë punonjësve të DHSK-së. Ngarkesa e konsiderueshme në punë u shtua pavarësisht vështirësive shumë reale nga KOVID-19, si në nivelin personal ashtu edhe në nivelin profesional, dhe çojmë shumë përkushtimin e jashtëzakonshëm të Gjykatësve dhe të punonjësve.

Me katër çështje gjyqësore ku përfshihen tetë të akuzuar, aktivitetet gjyqësore të DHSK-së u shtuan edhe më shumë gjatë vitit 2021. Dy nga çështjet gjyqësore kaluan në fazën e gjykimit, ndërsa dy çështjet e tjera gjyqësore janë ende në fazën e procedurës paraprake. Nga dy çështjet gjyqësore që filluan me gjykim, Prokurori i Specializuar përfundoi paraqitjen e provave në një çështje dhe Mbrojtja filloi paraqitjen e provave të veta nga fundi i vitit 2021. Paneli i Apelit ka pasur në shqyrtim një numër të shtuar të apeleve gjatë vitit nga shtatë të akuzuarit që përfshijnë tri çështje gjyqësore të ndryshme.

DHSK ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera gjyqësore. Në mars, gjykatësit mbajtën seancë plenare përmes videokonferencës, gjatë së cilës gjykatësit morën informacion të përditësuar mbi çështje të rëndësishme institucionale dhe trajtuan tema të ndryshme të rendit ditor të seancës plenare.

Krahas aktiviteteve gjyqësore, në shtator ne udhëtuan edhe në Kosovë për t'u takuar me shoqërinë civile, median, dhe Rrjetin e Informimit të Gjykatës dhe të tjerë në mënyrë që të ofronim informacion lidhur me punën e DHSK-së, të dëgjonim mendime dhe t'u përgjigjeshim pyetjeve. Ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që morën pjesë në këto takime personalisht ose përmes videokonferencës dhe çojmë komentet që morëm më pas në këto mbledhje.

Ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim vazhdoi me organizimin e aktiviteteve të shumta, kryesisht përmes videokonferencës, me përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile në Kosovë. DHSK-ja gjithashtu u takua disa herë me RRIJGJ-në, që na dha komente të vyera në lidhje me përmbajtjen dhe efektivitetin e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të gjykatës. Në këtë aspekt, ne i jemi mirënjohës qeverisë zvicerane, e cila me mbështetjen e saj financiare mundësoi veprimtarinë e DHSK-së për komunikim dhe ndërgjegjësim në Kosovë. Shfrytëzojmë rastin t'i shprehim mirënjohje qeverisë zvicerane për zotimin e saj të përsëritur në mbështetjen e përpjekjeve të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim duke dhënë pëlqimin për të vazhduar financimin e veprimtarive gjatë periudhës 2022-2023.

Me shtimin e vazhdueshëm të aktiviteteve gjyqësore në DHSK, u shtua edhe interesimi për aktivitetet e saj. DHSK-ja mbetet e përkushtuar për sigurimin e qasjes së lehtë dhe transparente në informacion lidhur me proceset. Në këtë aspekt, DHSK-ja në faqen e saj të internetit ka përfshirë përditësim në kohë reale, me lidhjet që të nxjerrin në parashtrim publike dhe procese gjyqësore, të cilat transmetohen në kohë reale, me njëfarë vonesë, në të tri gjuhët zyrtare të gjykatës. Pas komenteve që morëm gjatë misionit tonë në Kosovë, DHSK-ja filloi me informime javore për median, gjatë të cilave gjykata informon lidhur me zhvillimet në proceset gjyqësore për atë javë dhe u përgjigjet pyetjeve të mediave. Gjithashtu, gjykata filloi me transmetimin e seancave publike në kanal YouTube të DHSK-së.

Kemi kënaqësinë që përveçse i bëmë dokumentet publike të disponueshme në faqen e internetit të DHSK-së në arkivin e dokumentacionit gjyqësor publik, u nënshkrua marrëveshja me Qendrën për Hulumtim dhe Politika të së Drejtës Ndërkombëtare për ta bërë të disponueshëm dokumentacionin gjyqësor publik edhe përmes *Legal Tools Database* të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, arkiv kryesor në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare në internet.

Me Strategjinë kundër ngacimit në vendin e punës të vitit 2019, DHSK-ja përsëriti përkushtimin e saj për të marrë të gjitha masat e nevojshme në parandalimin dhe shqyrtimin e ngacimit në vendin e punës dhe në promovimin e një kulture me dinjitet dhe respekt të ndërsjellë. Organizimi i trajnimit të specializuar mbi parandalimin e ngacimit psikologjik dhe seksual ishte element i qenësishëm i Strategjisë, që u vijua nga 95% të drejtuesve të parë dhe të dytë si dhe nga anëtarë të Organit përfaqësues të punonjësve.

Dëshirojmë t'u shprehim mirënjohje të thellë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve të treta kontribuese, për mbështetje të palëkundur në sajë të së cilës DHSK-ja arriti të gjitha ato që arriti gjatë vitit 2021. Ne gjithashtu i jemi

mirënjohës Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë për mbështetjen e tyre të vyer gjatë operacioneve komplekse dhe gjithashtu policisë së Kosovës për ndihmën e tyre në këtë aspekt.

Njëkohësisht u shprehim mirënjohje homologëve të DHSK-së në Shërbimin e Jashtëm të BE-së, në Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe në Zyrën e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil, për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre me DHSK-në gjatë vitit 2021.

Gjithashtu u shprehim mirënjohje shteteve, trupit diplomatik si dhe gjykatave ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara në Hagë për bashkëpunimin dhe shkëmbimet e rregullta konstruktive në lidhje me çështje organizative dhe administrative. Në disa raste, ky bashkëpunim shtrihet edhe në shkëmbime të punonjësve. Në vitin 2021, në bazë të një Memorandumi për Mirëkuptim me Tribunalin Special për Libanin, patëm kënaqësinë të shkëmbenim dijeninë dhe ekspertizën me një gjykatë tjetër duke i huazuar punonjësit njëri-tjetrit.

Vitin që vjen presim që DHSK-ja të vijojë me proceset në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshëm, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e saj.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, dhjetor 2021

Dr. Fidelma Donlon

Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në **janar 2011**, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë të regjimit serb, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organ që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në **shtator 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, në **prill 2014** u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojn nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcakton se këto dhoma të dedikuara dhe të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me ligjin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, dhe do të

përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se dhomat e veçanta gjyqësore do të kishin seli në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në **prill 2014** dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.

Në **korrik 2014**, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se “TFHS-ja do të jetë në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, çka shënon fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, Dejvid Shvendiman (David Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së dhe filloi punën në janar 2017.

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me shtetin pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, nëntëmbëdhjetë gjykatës u emëruan në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 215 avokatë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

Në **maj 2018**, Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018** u ngrit Rrjeti i informimit të Gjykatës, që përfshin OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas Dejvid Shvendimanit, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua Xhek Smith (Jack Smith).

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në mjediset e reja në Hagë.

Në shkurt dhe **prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u riemërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020** bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Më **16 mars 2021**, z. Pjetër Shala u arrestua në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më **15 prill 2021**.

Më **5 maj 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor I për çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*, që filloi me procesin e gjykimit më **15 shtator 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më **15 korrik 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor II në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, që filloi me procesin e gjykimit më **7 tetor 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Kronologji



JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

SHTATOR 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.



DHJETOR 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

SHTATOR 2016

Z. Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, çka shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.

JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me shtetin pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.

**SHKURT 2017**

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

KORRIK 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

**SHTATOR 2018**

Z. Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas z. Dejvid Shvendiman.

**MAJ 2018**

Z. Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

NËNTOR 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së.

Kronologji



QERSHOR 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në mjediset e reja.

SHKURT DHE PRILL 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.



PRILL 2020

Administratorja Fidelma Donlon riemërohet edhe për një mandat katërvjeçar.



Gjykatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjykatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)



Gjykatës Zhilber Biti
(Francë)



Gjykatës Daniel Fransen
(Belgjikë)



Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjykatëse Romina Inkuti
Gjykatëse Kushtetuese
Rezervë (Itali)

SHTATOR 2020

Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

NËNTOR 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Taçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

**DHJETOR 2020**

Kryetarja Ekaterina Trendafilova rëmërohet për një mandat katërvjeçar.

**MARS DHE PRILL 2021**

Z. Pjetër Shala arrestohet në Belgjikë dhe transferohet në objektin e paraburgimit të DHSK-së.


**TETOR 2021**

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

**SHTATOR 2021**

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas Shkëmbimit të Letrave në përputhje me ligjin e Kosovës, me anë të amendamentit kushtetues në 2015. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit)

■ DHSK-ja është krijuar në përputhje me Shkëmbimin e Letrave dhe ligjin e Kosovës, dhe

- ka të njëjtat shkallë gjykimi si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese).
- ka seli jashtë Kosovës
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuese
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikurse përcaktohet në Ligj
- zbaton rregulloren e vet të procedurës dhe provave.

■ DHSK-ja është institucion gjyqësor i përkohshëm


- që do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.

■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve
 - që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
 - që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

■ DHSK-ja merret vetëm me përgjegjësi penale individuale - nuk mund të gjykohen grupe ose organizata.

- DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procese gjyqësore.
- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.
- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.
- DHSK-ja ka **Avokatin e Popullit**, i cili vepron në mënyrë pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që **ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në**, ndër të tjera
 - përmes procedurës së parashtrimit të ankesave prej personave
 - nëse ankesa ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në
 - në rast të vonesave të paarsyeshme të një procesi në DHSK
 - nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike të tjera
 - nëse ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar
- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.







Masat e KOVID-19

Nga mesi i marsit 2021 u bë një vit që kur DHSK-ja dhe ZPS-ja vunë në zbatim sistemin e punës nga distanca për shumicën e punonjësve si rezultat i pandemisë KOVID-19. Vendimi që vetëm një numër i kufizuar i punonjësve të jenë të pranishëm në zyra mbeti në fuqi gjatë pjesës së madhe të vitit. Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) vazhdoi të shtojë kapacitetin e sistemit që mundëson punën nga distanca për deri në 400 përdorues në ditë gjatë kulmit të punës nga distanca në vitin 2021.

Rregulloret e brendshme u përditësuan rregullisht për të mundësuar sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve, kontraktuesve dhe praktikantëve, personave të lidhur me organizatat, siç janë dëshmitarët dhe të ndaluarit, si dhe të atyre që vizitojnë mjediset e gjykatës. Shefi i Administratës, përmes pikës së kontaktit të dedikuar për KOVID-19 informoi punonjësit për çdo masë të miratuar ose të ndryshuar në bazë të këshillave dhe rekomandimeve të qeverisë holandeze. DHSK-ja dhe ZPS-ja ishin plotësisht funksionuese për të gjitha veprimet gjyqësore dhe administrative gjatë gjithë vitit si rezultat i masave në fuqi dhe të përkushtimit dhe motivimit të punonjësve të tyre.

Për mundësimin e përcjelljes së seancave publike në mjediset e DHSK-së hynë në fuqi masa parandaluese dhe lehtësuese, ndër të cilat pyetësorë lidhur me shëndetin, mbajtja e maskave dhe ulja në galerinë publike në përputhje me rregullat për mbajtjen e distancës. Në sallën e gjyqit u vendosën ndarëset e tejdukshme dhe në disa raste u kërkua mbajtja e maskave.

Natyrisht obligimi i DHSK-së për kujdes përfshin edhe të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të DHSK-së si dhe personelin që punon aty. Administratorja bashkë me ekipin e Njesisë së Paraburgimit (NJP) patën kontakt dhe bashkëpunim të ngushtë me mjekun e Njesisë së Paraburgimit për të siguruar se të gjitha procedurat në NJP janë të përditësuara dhe për të mbajtur një ambient të sigurt.

Administratorja gjithashtu u angazhua me shtetin pritës për t'u dhënë përparësi të paraburgosurve në programin kombëtar të vaksinimit kundër KOVID-19.

Më 14 shtator, shteti pritës lajmëroi se nga 25 shtatori do të hiqeshin shumica e masave të KOVID-19. Megjithatë, DHSK-ja dhe ZPS-ja i mbajtën masat në fuqi, duke lejuar gjithashtu kthimin e më shumë punonjësve, i nevojshëm për shkak të shtimit të aktiviteteve gjyqësore.


Më 5 tetor, drejtuesit, gjatë një takimi me punonjësit, lajmëruan fillimin e fazës 2 të përgjigjes së DHSK-së dhe ZPS-së ndaj pandemisë, që përfshinte kthimin gradual të sigurt të të gjithë punonjësve të tyre në mjediset në Hagë. Qasja në faza synonte kthimin e të gjithë punonjësve në zyra me orar të plotë nga fillimi i vitit 2022. Megjithatë, njoftimet e shtetit pritës si rezultat i rritjes së numrit të infektiveve me KOVID-19 në Holandë pezulloi dhe shtyu përkohësisht planin e kthimit në zyra. Për ata që punonin nga zyra mbetën në fuqi masat parandaluese kundër KOVID-19 në vijim: mbajtja e maskës në zyra; respektimi i distancës; përdorimi sa më i madh i videokonferencës gjatë takimeve me palë të jashtme; larja dhe dezinfektimi i rregullt i duarve; dhe vetëmonitorimi i simptomave të KOVID-19.

DHSK-ja dhe ZPS-ja mbetën në hap me zhvillimet dhe ishin të gatshme të ndryshonin reagimet e tyre sipas nevojës. Në këtë aspekt, vazhdoi kontakti i ngushtë me autoritetet holandeze për të siguruar respektimin e të gjitha masave shëndetësore dhe rekomandimeve publike shtetërore.

Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar, u dërguan mesazhe javore punonjësve, për t'i mbajtur të informuar lidhur me zhvillimet kryesore të javës, për t'i mbështetur dhe ruajtur motivimin e tyre, si dhe për t'i falënderuar punonjësit për përkushtimin e tyre të vazhduar. Me numrin e shtuar të punonjësve në mjediset e gjykatës, pas 85 javësh mesazhi javor i fundit u dërgua në nëntor.



Dhomat



1 | Aktivitetet gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) kanë shënuar një numër arritjesh gjyqësore të konsiderueshme gjatë vitit 2021, me arrestimin në mars dhe transferimin në prill të të akuzuarit të tetë dhe fillimin e dy gjykimeve në çështjet *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës dhe Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*, përkatësisht në shtator dhe tetor. Këto arritje u realizuan me gjithë pandeminë aktuale nga KOVID-19 dhe janë një pasqyrë e profesionalizmit, përkushtimit dhe vendosmërisë së palëkundshme të gjykatësve të DHSK-së dhe punonjësve që i mbështesin ata.

Gjatë vitit 2021 një numër panelesh u angazhuan me aktivitete gjyqësore, përfshirë Gjykatësin e Procedurës Paraprake, i cili është i caktuar në dy çështje gjyqësore aktuale, dy Trupa Gjykues për dy gjykime dhe Panele të Gjykatës së Apelit, të cilat kanë lëshuar vendime lidhur me apele të ndërmjetme si rrjedhojë e këtyre proceseve. Gjithashtu, Kryetarja lëshoi një numër vendimesh lidhur me kërkesat për vetëtërheqje dhe/ose heqje. Gjithsej, gjykatësit e DHSK-së kanë lëshuar afërsisht 800 vendime dhe urdhra gjatë vitit 2021, ndër të cilët mbi 130 me gojë.

PROCESET PARA TRUPAVE GJYKUES

Më 2021 DHSK-ja filloi me dy gjykime, ku në një prej tyre u kalua në paraqitjen e provave nga ana e Mbrojtjes nga fundi i vitit 2021.

I.

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafa

Çështja gjyqësore kundër z. Salih Mustafa ishte çështja e parë e DHSK-së që kaloi në gjykim. Aktakuza e ngarkon z. Mustafa me katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme) të kryera në prill 1999. Në aktakuzë pretendohet se gjatë periudhës përkatëse z. Mustafa ishte komandant i një njësie guerile brenda zonës operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).



Z. Salih Mustafa gjatë konferencës përgatitore, 9 qershor 2021

Më 5 maj, Kryetarja caktoi Gjykatësit Mapi Feld-Folia (kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë) në Trupin Gjykues I. Ata u caktuan pas njoftimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se dosja e çështjes do të ishte gati t'i kalohej një Trupi Gjykues më 7 maj.



Deklaratat hyrëse në çështjen Mustafa, 15 shtator 2021

Procesi i gjyimit filloi me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar dhe mbrojtëses së viktimave më 15 shtator. Nga fundi i dhjetorit Prokurori i Specializuar thirri 10 dëshmitarë. Nëntë persona u pranuan të marrin pjesë si viktima në proces dhe Trupi Gjykues shtyu afatin për paraqitje

të kërkesës nga viktimat deri në përfundim të paraqitjes së provave nga Prokurori i Specializuar. Gjithsej tetë persona aktualisht ende marrin pjesë si viktima në këtë çështje.

Mbrojtja e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave duhet të kuptohet si pjesë thelbësore e interesave dhe të drejtave personale të viktimave, edhe pse nuk përmendet shprehimisht në nenin 22 të Ligjit.

KSC-BC-2020-05/F00152, Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjyimit, 12 korrik 2021, para. 11.

II.

Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt

Çështja e dytë në DHSK që kaloi në gjykim është ajo e z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj. Që të dy akuzohen për katër vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, dhe dy vepra penale kundër rendit publik, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, frikësimit, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës.

Më 15 korrik, Kryetarja caktoi në Trupin Gjykes II Gjykatësit Çarls Smith, III (kryegjykatës), Kristof Barte, Gënel Metro dhe Fergal Gejnor (rezervë). Caktimi u bë pas njoftimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake se dosja e çështjes do të jetë gati të kalojë te një Trup Gjykes më 16 korrik.



Trupi Gjykes II gjatë deklaratave hyrëse në çështjen Gucati dhe Haradinaj, 7 tetor 2021

Gjykimi filloi me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar më 7 tetor. Prokurori i Specializuar thirri katër dëshmitarë dhe mbylli çështjen më 10 nëntor. Më 26 nëntor, Trupi Gjykes II hodhi poshtë kërkesat e z. Gucati dhe z. Haradinaj për rrëzimin e akuzave

kundër tyre në përputhje me rregullën 130 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (Rregullorja) dhe në një vendim tjetër përsëriti rëndësinë e proceseve publike.

Kuadri ligjor dhe normativ i Dhomave të Specializuara ("DHS") përcakton se proceset janë parimisht publike, përveçse kur mbrojtja e një interesi legjitim konkurrues përligj përjashtimin nga ky parim. Trupi Gjykues vëren se parimi i procesit publik mbron jo vetëm të drejtat themelore të të Akuzuarve për një gjykim publik dhe të drejtë, por siguron edhe besimin në procesin gjyqësor nëpërmjet transparencës, çka përbën një garanci të rëndësishme kundër arbitraritetit.

KSC-BC-2020-07/F00303, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse, 7 shtator 2021, para. 9.

Paraqitja e provave të Mbrojtjes filloi më 3 dhjetor, kur mbrojtësi i z. Gucati dha deklaratën e tij hyrëse. Mbrojtja thirri z. Gucati si dëshmitar të parë më 6 dhjetor. Deri nga mesi i dhjetorit Mbrojtja thirri

dëshmitarin e gjashtë të saj. Mbrojtja e z. Haradinaj dha deklaratën e saj hyrëse më 15 dhjetor, paraqitja e provave të së cilës ishte planifikuar të fillonte më 11 janar 2022.



Z. Hysni Gucati gjatë deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar, 7 tetor 2021



Z. Nasim Haradinaj gjatë deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar, 7 tetor 2021

PROCEDURAT PARA GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE

Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i angazhuar aktivisht gjatë vitit 2021 dhe mori të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin dhe përgatitjen e shpejtë të çështjeve për gjykim, në përputhje me rregullën 95(2) të Rregullores. Në fillim të vitit Gjykatësi i Procedurës Paraprake u ngarkua me të katër çështjet aktualisht para DHSK-së. Deri në verë të vitit 2021,

Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte përfunduar procedurën paraprake në dy çështje dhe i kaloi ato te Trupat Gjykues të caktuar (përkatësisht, Prokurori i Specializuar kundër Mustafës dhe Prokurori i Specializuar kundër Gucatit dhe Haradinajt). Deri në fund të vitit 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte ende i ngarkuar me dy çështje gjyqësore.

I. Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Procedura paraprake në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve ishte në vazhdim e sipër në fund të vitit 2021. Aktakuza ngarkon z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi me 10 akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Gjatë vitit 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendime dhe urdhra të një spektri të gjerë, ndër të tjera lidhur me nxjerrjen e provave, pjesëmarrjen e viktimave, paraburgimin e të akuzuarve, themelimin dhe juridiksionin e DHSK-së si dhe mangësi në formën e aktakuzave.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e themeluar me ligj është një e drejtë absolute dhe nuk mund të kufizohet.

KSC-BC-2020-06/F00450, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 31 gusht 2021, para 86.



Procedura Paraprake në çështjen Thaçi dhe të tjerët, 14 shtator 2021

Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi 20 persona si viktime pjesëmarrëse dhe procesi për paraqitje të kërkesës për status si viktimë është ende i hapur.

II.

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Çështja e katërt gjyqësore ka të bëjë me z. Pjetër Shala, i cili pretendohet të ketë qenë anëtar i UÇK-së i vendosur në Kukës, Shqipëri. Z. Shala u arrestua më 16 mars në Belgjikë dhe u transferua në DHSK më 15 prill 2021. Ai ngarkohet me katër akuza për krime lufte, që pretendohet se u kryen midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999 kundër personave të ndaluar në

Fabrikën e Metalit në Kukës (Shqipëri) që pretendohet se shfrytëzohej nga UÇK-ja.

Në seancën e paraqitjes së parë të tij më 19 prill, z. Shala u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.



Paraqitja e parë në çështjen Shala, 19 prill 2021

Procedura paraprake në këtë çështje është duke u kryer në mënyrë të shpejtë, gjatë së cilës Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka lëshuar vendime dhe urdhra të një spektri të gjerë, ndër të tjera lidhur me paraburgimin e z. Shala, pjesëmarrjen e viktimave dhe juridiksionin e DHSK-së.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi një person si viktimë pjesëmarrëse në proces dhe procesi për paraqitje të kërkesës për status si viktimë në këtë çështje gjyqësore është ende i hapur.



Z. Pjetër Shala gjatë seancës së paraqitjes së parë të tij, 19 prill 2021

Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në pajtim me nenet 21(4)(a) dhe 38(4) të Ligjit, si dhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përmbajë faktet në të cilat mbështeten akuzat dhe veprat penale, përfshirë format e përgjegjësive të përfshira në aktakuzë, të paraqitura me konkretësi dhe qartësi të mjaftueshme. Kjo konkretësi dhe qartësi duhet të sigurojë që aktakuza, si dokument më vete, t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.

KSC-BC-2020-04/RED/F00089, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 18 tetor 2021, para. 25.

PROCEDURAT PARA GJYKATËS SË APELIT

Kundrejt përparimit të madh në të katër çështjet gjyqësore, panelet e Gjykatës së Apelit kanë qenë gjithashtu të ngarkuara me apele të një spektri të gjerë më 2021, të parashtruara prej shtatë nga tetë të akuzuarit, në tri çështje gjyqësore të ndryshme. Ata kanë lëshuar vendime ku konfirmuan vazhdimin

e paraburgimit të disa prej të akuzuarve, dhe kanë trajtuar aspekte lidhur me detyrimin për nxjerrjen e provave, pjesëmarrjen e viktimave dhe kundërshtimeve të ngritura ndaj formës së aktakuzës si dhe juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Rishikimi i paraburgimit në pritje të gjykimit duhet të ketë si pikënisje parimin e prezumimit të pafajësisë. Nga kjo, së pari, rrjedh se paraburgimi në pritje të gjykimit është aspekt për të cilin nuk mund të vendoset lehtë. Së dyti, ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi është i domosdoshëm.

KSC-BC-2020-06/IA002,F00005/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit Kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm, 30 prill 2021, para. 23.

Mundësia e sigurimit të standardeve minimale për një pjesëmarrje reale dhe domethënëse të viktimave në proces ka lidhje me zbatimin e mekanizmave solidë të pjesëmarrjes, në përputhje me kornizën ligjore të gjykatës përkatëse. Në rast të kundërt, pjesëmarrja e gjerë e viktimave mund të shndërrohet lehtësisht në një akt të thjeshtë simbolik, pa ndikim real në zbatimin efektiv të të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe drejtësi.

KSC-BC-2020-06/IA005/F00008, Vendimi mbi Apelin Kundër "Vendimit të parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave", 16 korrik 2021, para. 26.

Gjykatësit e caktuar në Panelet e Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2021



Gjiatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjiatës Emilio Gati
(Itali)



Gjiatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjiatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)

KËRKESAT PËR HEQJE

Gjatë vitit 2021, Kryetarja lëshoi një numër vendimesh lidhur me kërkesat për heqjen e saj si dhe të dy gjykatësve. Kërkesat për heqje u parashtruan pas paraqitjes së saj para përfaqësuesve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (BE) në dhjetor 2020 dhe në Hagë në shkurt 2021. Kërkesat për heqjen e dy gjykatësve të tjerë u bazuan në punësimin e

mëparshëm të njërit gjykatës dhe caktimin në apel të gjykatësit tjetër nga Kryetarja.

Kërkesat u trajtuan në pajtim me kornizën ligjore të DHSK-së dhe përfundimisht u hodhën poshtë, duke mundësuar kështu vazhdimin e pandërprerë të proceseve.

[A]s Ligji dhe as Rregullorja nuk parashikojnë, heqjen në bazë të kërkesës së një pale, të Kryetares që ushtron kompetencat e saj administrative, e aq më pak ndalimin e nxjerrjes së vendimeve ose urdhrave të ardhshëm administrativë.

KSC-BC-202007/F00272, Vendimi mbi Kërkesën për Vetëtrheqjen ose Heqjen e Gjykatësve, 6 gusht 2021, para. 22.

2 | Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksione gjyqësore sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera për shkak se janë në Regjistër, por vetëm kur caktohen nga Kryetarja për të kryer funksionet zyrtare të tyre. Gjykatësit e caktuar për aq sa është e mundur kryejnë funksionet gjyqësore të tyre nga distanca.

PLENARJA VJETORE

Më 19 mars, Gjykatësit u mbledhën për plenaren e gjashtë të tyre, të cilën përsëri e mbajtën përmes videokonferencës si rezultat i pandemisë së KOVID-19. Gjatë plenares, Gjykatësit përditësuan Kryetaren dhe dëgjuan prezantime lidhur me DHSK-në dhe përfshirjen e tyre në përmbushjen e mandatit të saj.



3 | Aktivitetet e jashtme

Gjatë vitit 2021, Kryetare Trendafilova mundësoi informimin e rregullt të publikut dhe palëve të interesuara në lidhje me aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim, Kryetarja u takua me përfaqësues të institucioneve të BE-së, të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuese, të shtetit pritës, përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë, dhe OJQ-ve.



Kryetare Trendafilova

Më 11 shkurt, Kryetarja përditësoi shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese përmes videokonferencës lidhur me zhvillimet kyçe të DHSK-së. Shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese ritheksuan mbështetjen e tyre të fuqishme për punën e institucionit, për çka Kryetarja shprehu mirënjohjen e saj.

Kryetarja u paraqit personalisht para Komitetit Politik dhe të Sigurisë së BE-së më 27 tetor në Bruksel, ku i informoi shtetet anëtare lidhur me aktivitetet gjyqësore të DHSK-së dhe iu përgjigj pyetjeve të shteteve anëtare të BE-së.

Për të forcuar më tej marrëdhëniet e DHSK-së me aktorë të tjerë të jashtëm dhe me shoqërinë civile, Kryetarja zhvilloi takime (kryesisht përmes videokonferencave) me përfaqësues të fushës diplomatike, juridike dhe akademike. Kryetarja gjithashtu u dha intervista mediave të shumta, gjatë së cilës ajo përmendi mandatin dhe punën e DHSK-së, përfshirë misionin e saj me Administratoren në Kosovë në shtator.

Pavarësia e gjykatësve është parimi themelor i profesionit juridik. Ajo pasqyrohet në të gjitha instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale që lidhen me gjyqësorin, si dhe në betimin solem që ne si gjykatës të Dhomave të Specializuara e japim para se të marrim detyrën. Ky betim është me rëndësi thelbësore për secilin prej nesh dhe na udhëzon në çdo gjë që ne bëjmë në Dhomat e Specializuara.

Kryetare Trendafilova, Intervistë me ABC News Albania, 14 prill 2021.

Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare
(Bullgari)



Gjykatës Çarls L. Smith III
Nënkryetar
(SHBA)



Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Kushtetues
(Norvegji)



Gjykatës Antonio Balsamo
Gjykatës Kushtetues
(Itali)



Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjykatëse Romina Inkuti
Gjykatëse Kushtetuese
Rezervë (Itali)



Gjykatëse Kristinë van den
Vajngart
(Belgjikë)



Gjykatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjykatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gati
(Itali)



Gjykatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjykatës Mihael Bolander
(Gjermani)



Gjykatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjykatës Kenet Roberts
(Kanada)



Gjykatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)



Gjykatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjykatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjykatës Gënel Metro
(Zvicër)



Gjykatës Nikola Giju
(Francë)



Gjykatës Zhibler Biti
(Francë)



Gjykatës Daniel Fransen
(Belgjikë)




Gjykatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjykatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)

Marrëdhëniet me jashtë



Marrëdhëniet me jashtë

Me fillimin e proceseve gjyqësore, Kryetarja dhe Administratorja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) kanë marrë rolin e rëndësishëm për t'i shpjeguar publikut në Kosovë dhe rajon si punon gjykata për mundësimin e proceseve gjyqësore të drejta, sigurta dhe efektive në përputhje me standardet më të larta të drejtësisë penale ndërkombëtare. Për këtë qëllim, ato kanë rritur konsiderueshëm pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet komunikuese dhe ndërgjegjësuese të DHSK-së dhe punën e tyre me gazetarë gjatë vitit 2021.

Më 23 shkurt, drejtuesit pritën kryetarin e komunës së Hagës, z. Jan van Zanen, në mjediset e gjykatës, ku e informuan për llojin dhe mandatin e DHSK-së dhe ZPS-së.

Më 19 maj, Kryetarja dhe Administratorja u takuan me anëtarë të Rrjetit të Informimit të Gjykatës (RRIGJ), gjatë të cilit ato dhanë një përmbledhje të shkurtër të punës në zhvillim e sipër në gjykatë dhe morën komente nga anëtarët e RRIGJ-së lidhur me aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimin të DHSK-së.

Më 25 maj, Shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), z. Lars-Gunar Vigemark (Lars-Gunnar Wigemark), u mirëprit në mjediset e gjykatës.

Drejtuesit mbajtën takime të ndara, gjatë të cilave shprehën mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të EULEX-it për gjykatën.

Nga 6 deri më 9 shtator, Kryetarja dhe Administratorja shkuan në Kosovë për t'u angazhuar në dialog me shoqërinë civile, gazetarë dhe publikun e gjerë lidhur me punën e DHSK-së. Ato mbajtën dy aktivitete komunikuese dhe ndërgjegjësuese me shoqërinë civile në Prishtinë dhe në Mitrovicë. Gjatë këtyre aktiviteteve Kryetarja dhe Administratorja informuan publikun për proceset gjyqësore në zhvillim e sipër dhe për mbështetjen gjyqësore të Zyrës Administrative, dhe iu përgjigjën pyetjeve të gazetarëve dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile që morën pjesë fizikisht ose përmes internetit.

Kryetarja dhe Administratorja gjithashtu u takuan me përfaqësues diplomatikë të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, ndër të cilët me Ministren e Drejtësisë së Kosovës, Sh.S. znj. Albulena Haxhiu. Kryetarja dhe Administratorja iu drejtuan edhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve të treta kontribuese në një takim të kryesuar nga Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, z. Tomash Sunjog (Tomáš Szunyog) dhe i mbajtur nga Shefi i Misionit të EULEX-it, z. Lars-Gunar Vigemark.



Kryetarja Trendafilova duke folur gjatë takimit të komunikimit dhe ndërgjegjësimin në Prishtinë, 7 shtator 2021



Administratorja Donlon duke folur gjatë takimit të komunikimit dhe ndërgjegjësimin në Prishtinë, 7 shtator 2021



Intervista e Kryetares Trendafilova në emisionin Rubikon në KlanKosova, 7 shtator 2021

Më 2021, Kryetarja dha katër intervista për mediat në Kosovë dhe rajon, dhe botoi një artikull në shqip dhe serbisht në mediat kosovare lidhur me proceset e gjyqimit para DHSK-së. Administratorja dha dy

intervista në Kosovë dhe botoi një artikull se si dëgjohej zëri i viktimave në proceset në DHSK, i botuar po ashtu në shqip dhe serbisht.



Administratorja Donlon në një intervistë në RTK2, 7 shtator 2021

Fillimi i gjykimeve në lidhje me akuzat për krime brenda mandatit të Dhomave të Specializuara është një arritje e rëndësishme për vendosjen e drejtësisë. Tani këto akuza për krime do të trajtohen përmes proceseve gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura, mbështetur në standardet ndërkombëtare të cilat do të zbatohem me rreptësi dhe në pajtim me parimin e procesit ligjor të rregullt.

Kryetare Trendafilova, Artikull lidhur me proceset gjyqësore para Dhomave të Specializuara të Kosovës, botuar në "Kosovo Online" (serbisht) dhe "Zëri" (shqip), 3 shtator 2021.

Përkatësisht më 21 shtator dhe 9 nëntor Kryetarja dhe Administratorja pritën zëvendësministrin e Drejtësisë së Kosovës, z. Blerim Sallahu, dhe Avokatin e Popullit të Kosovës, z. Naim Qelaj në mjediset e gjykatës, ku u dhanë mundësinë të merrnin përgjigje për pyetjet lidhur me mandatin e DHSK-së dhe gjithashtu të vizitonin sallën e gjyqit.

Më 19 tetor, drejtuesit mirëpritën shefin e ri të Drejtimit të Sektorit të Operacioneve të Zyrës Evropiane për Planifikim dhe Drejtëm Civil, z. Kaiko Altoma (Kauko Aaltomaa) në mjediset e gjykatës. Gjatë takimit me drejtuesit z. Altoma u informua për ecurinë e proceseve në vijim të DHSK-së.

Më 25 nëntor, drejtuesit përditësuan, nëpërmjet videokonferencës, përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese në Hagë, mbi punën e DHSK-së dhe ZPS-së gjatë takimit të tyre vjetor.

Së fundi, Kryetarja dhe Administratorja u takuan me shefin e Sektorit të Drejtësisë Ndërkombëtare të Ministrisë së Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, z. Mihael Domen (Michael Dohmen), më 30 nëntor.

Këshilli [i BE-së] thekson nevojën për përkushtim të vazhdueshëm të Kosovës lidhur me Dhomat e Specializuara, si një tregues i rëndësishëm i përkushtimit të saj ndaj sundimit të ligjit dhe për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë. Korniza ligjore ekzistuese mundëson hetimin dhe ndjekjen penale të mirëfilltë të të gjitha krimeve të pretenduara të luftës. Në këtë aspekt, Këshilli shpreh mirënjohje për punën e Dhomave të Specializuara që rezultoi në fillimin e gjykimeve të para këtë vit në Hagë.

Përfundimet e Këshillit të Evropës për Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizimit dhe Asociimit, 14 dhjetor 2021, para. 70.

Zyra Administrative



Zyra Administrative

Administratorja drejton Zyrën Administrative që mundëson administrimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe ofron një spektër të gjerë shërbimesh mbështetëse gjyqësore në mënyrë të paanshme dhe të pavarur. Ajo ka bashkëpunim të ngushtë me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar për çështje institucionale.

Mbështetja administrative që ofron Zyra Administrative për Dhomat dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar përfshin buxhetin, financimin, prokurimin, teknologjinë e informacionit, administrimin e objekteve, personelin dhe sigurinë. Mbështetja gjyqësore përfshin mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, përkthimin me shkrim dhe me gojë, administrimin e gjykatës dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Dr. Fidelma Donlon është Administratore, ajo e mban këtë post që nga prilli 2016. Ajo është përgjegjëse për shërbimet mbështetëse administrative dhe gjyqësore të gjykatës, nënshkruese në emër të DHSK-së dhe ZPS-së e marrëveshjes për subvencionim me Bashkimin Evropian (BE), që është burimi kryesor i financimit të gjykatës.

Nën udhëheqjen e Administratores, punonjësit e Zyrës Administrative dhanë një kontribut të konsiderueshëm në rritjen dhe zhvillimin e organizatës, si dhe ofrimin e shërbimeve të efektshme të nevojshme për mundësimin e fillimit dhe mbështetjes së dy gjykimeve dhe vazhdimin e procedurës paraprake në dy çështje gjyqësore të tjera.

Zyra Administrative është e përkushtuar në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve gjyqësore dhe administrative që ajo ofron. Monitorimi i vazhdueshëm, dhe rishikimi i rregullt i praktikave dhe rregulloreve ekzistuese i mundëson Zyrës Administrative që të identifikojë aspektet që duhen përmirësuar dhe zhvilluar.



Administratore Fidelma Donlon

Me fillimin e gjykimeve në shtator 2021, Administratorja pati mundësinë e vyer që të mbikëqyrte funksionimin e plotë të Zyrës Administrative gjatë muajve të parë të gjykimeve.

Kjo ndihmoi në diskutimet e drejtuesve se si të vijohet me ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për proceset gjyqësore, si dhe në planifikimin e zhvillimit të rregulloreve të brendshme thelbësore. Në kuadër të kësaj, Administratorja ka përcaktuar disa prioritetet strategjike për periudhën e ardhshme.

Njëri prej këtyre prioriteteve strategjike ka të bëjë me zgjerimin e sistemit elektronik të administrimit gjyqësor, *Legal Workflow*, bazuar në komentet e të gjithë përdoruesve në fazën fillestare të proceseve. Në këtë aspekt, u formua Grupi i Punës i Zyrës Administrative lidhur me *Legal Workflow*, për bashkërendimin e komunikimit dhe testeve shtesë me të gjitha grupet e përdoruesve të *Legal Workflow* të DHSK-së dhe ZPS-së, identifikimin e rubrikave që mund të shtohen, komunikimin me programuesit dhe në mundësimin e realizimit të efektshëm të çdo ndryshimi të nevojshëm.


Një prioritet strategjik tjetër është përgatitja dhe miratimi i politikave të DHSK-së lidhur me ruajtjen dhe arkivimin, si dhe vendimmarrjen lidhur me infrastrukturën teknike që kërkohet për arkivin. Që nga viti 2016, Zyra Administrative ka bërë përpjekje të konsiderueshme për mundësimin e administrimit të sigurt të të gjithë informacionit elektronik dhe fizik, përfshirë përpilimin dhe miratimin e hershëm të Direktivës Administrative për Administrimin e

Aseteve të Informacionit. Objektivi i ri lidhur me ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve dhe informacionit është stadi i ardhshëm i rëndësishëm për sigurimin e sistemit të masave të forta të DHSK-së të administrimit të aseteve të informacionit.

Vazhdoi komunikimi me shtetin pritës lidhur me zbatimin e Marrëveshjes me Shtetin Pritës, shtetet e tjera lidhur me çështje bashkëpunimi, përfshirë mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe me shtetet anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese për nxitjen e emërimit të kandidatëve të kualifikuar në vende pune në DHSK dhe ZPS.

Në dhjetor 2021, u finalizua marrëveshja e bashkëpunimit midis DHSK-së dhe Qendrës për Hulumtim dhe Politikë të së Drejtës Ndërkombëtare (QHPDN). Në bazë të kësaj marrëveshjeje, të gjitha dokumentet publike të DHSK-së do të jenë të disponueshme për përdoruesit e *Legal Tools Database* të GJPN-së, një arkiv i materialeve të jurisprudencës dhe të drejtës penale ndërkombëtare, që administrohet dhe drejtohet nga QHPDN-ja. Administratorja gjithashtu nënshkroi në emër të DHSK-së me qeverinë zvicerane marrëveshjen për financim të veprimtarive të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së për vitet 2022 dhe 2023.





1 | Kabineti i Administratores

Kabineti i Zyrës së Administratores (KA) mbështet Administratoren në zbatimin e përgjegjësive të saj. Kjo përfshin një sërë detyrash ligjore dhe joligjore lidhur me proceset gjyqësore dhe administrimin e gjykatës, si dhe marrëdhëniet me shtetin pritës, marrëdhënie me publikun dhe komunikim dhe ndërgjegjësim, çështje diplomatike, bashkërendim të raportimit në BE dhe shërbime të ndryshme protokollare. Njësia e Administrimit të Informacionit (AdmInfo) gjithashtu përfshihet në përgjegjësinë e KA-së.

Më 2021, ekipi juridik i KA-së, i ofroi mbështetje Administratores në administrimin e pandemisë së KOVID-19 dhe vazhdimin pa pengesa të veprimtarisë dhe proceseve gjyqësore. Këtu përfshihen rekomandime për një sërë çështjesh ligjore të brendshme dhe të jashtme, ndër të cilat zhvillimi, interpretimi dhe zbatimi i instrumenteve të ndryshme ligjore, dhe administrimi i vijimësisë së punës. Gjithashtu, ekipi i ofroi Administratores mbështetje kyçe ligjore lidhur me kërkesat për bashkëpunim të jashtëm gjatë arrestimit dhe transferimit të një të paraburgosuri në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Ekipi gjithashtu mbikëqyri rishikimin dhe përgatitjen e rregulloreve dhe udhëzimeve të brendshme të ndryshme lidhur me administrimin e gjykatës dhe dorëzimin e 204 parashtrimeve në emër të Administratores lidhur me një spektër të gjerë temash në proceset gjyqësore. Këtu përfshihen parashtrimet me tema lidhur me paraburgimin, vizita te të paraburgosurit, mbrojtjen e dëshmitarëve, përgatitjen dhe mbështetjen e gjykimit, ndihmën dhe përfaqësimin juridik, pjesëmarrjen e viktimave, masa të zbutjes së rrezikut nga KOVID-19, si dhe arrestim dhe transferim.

Gjatë vitit 2021, KA-ja gjithashtu këshilloi dhe mundësoi hyrjen në Holandë për mbrojtësit dhe anëtarët e ekipeve të Mbrojtjes, si dhe anëtarëve të familjes së të paraburgosurve duke marrë parasysh kufizimet në udhëtim për shkak të KOVID-19.

Njësia e Administrimit të Informacionit në kuadër të Kabinetit të Administratores ofron këshilla për administrimin e sigurt të informacionit, dokumentacionit dhe arkivave të DHSK-së, si dhe për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm në të gjithë institucionin. Njësia e Administrimit të Informacionit gjithashtu ofroi shërbime bibliotekare dhe të mbështetjes në punën hulumtuese për të gjithë, përfshirë përdoruesve nga distanca. Gjatë vitit 2021, AdmInfo organizoi trajnime të herëpashershme mbi trajtimin e informacionit të klasifikuar dhe filloi dhe mori pjesë në projekte që kanë për synim fuqizimin e kornizës së politikës për informacion të ndjeshëm, siç është miratimi i Udhëzimit Operativ lidhur me Kontrollin e Qasjes në Asete të Informacionit në maj 2021. Në vjeshtë, puna për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave filloi me grumbullimin e të dhënave lidhur me të gjitha asetet e informacionit.

2 | Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJIKP) punon në shpërndarjen e informacionit të qartë dhe të saktë në lidhje me gjykatën dhe aktivitetet e saj në mënyrë që t'i bëjë proceset të kuptueshme për publikun dhe që të rrisë ndërgjegjësimin lidhur me mandatin e gjykatës për mundësimin e proceseve gjyqësore të drejta, të paanshme, të pavarura dhe të sigurta. Për këtë qëllim, njësia komunikon me gazetarë dhe shoqërinë civile, nxjerr videomateriale dhe materiale të tjera informuese, administron një program solid për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe drejton faqen në internet të DHSK-së dhe të kanalit në YouTube. Ajo gjithashtu organizon vizitat e grupeve dhe pjesëmarrjet në seanca publike.

Viti që shkoi shënoi një shtim të aktiviteteve në sallë të gjyqit në DHSK, duke qenë se dy çështje gjyqësore kaluan në gjykim dhe vazhduan seancat për përgatitjen e dy çështjeve të tjera gjyqësore, që aktualisht janë në fazën paraprake. Për rrjedhojë, numri i personave që ndoqën seancat publike në DHSK nëpërmjet transmetimit me video në faqe të internetit u rrit në mënyrë dramatike, dhe seancat u ritransmetuan gjerësisht nga mediat kosovare në televizion, në internet dhe nëpërmjet mediave sociale.

Në hap me këto zhvillime, objektivi i komunikimit të DHSK-së me publikun ka kaluar plotësisht në sallën e gjyqit dhe u përdoren mjete të reja për t'i bërë proceset të qasshme dhe të kuptueshme për një publik sa më të gjerë. Për shembull, zëdhënësit e DHSK-së shpjeguan zhvillimet në sallë të gjyqit dhe iu përgjigjën pyetjeve të gazetarëve që merrnin pjesë nga Kosova dhe rajoni ose kudo në botë në shqip, serbisht dhe anglisht. Më 2021, DHSK-ja gjithashtu filloi me postimin e incizimeve të të gjitha seancave publike në kanalën e saj në YouTube.

Me fillimin e proceseve gjyqësore, mediat dhe publiku në Kosovë dhe rajon kanë treguar interesim të madh lidhur me disa funksione kryesore mbështetëse të gjyqësorit në lidhje me gjykimet. Përmes materialeve filmike në televizion, intervistave me median, artikujve në shtyp dhe punës me gazetarët, njësia ka punuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të shpeshta mbi tema si mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve, pjesëmarrja e viktimave në gjykim dhe rregullat për vizita të paraburgosurit gjatë pandemisë së COVID-19.



Zëdhënësjë e DHSK-së Angela Grip duke dhënë informimin javor për mediat në internet lidhur me proceset

2.1 | Marrëdhëniet me mediat

Gjatë tërë vitit, DHSK-ja kërkoi mënyra të reja që zhvillimet jashtë dhe brenda sallës së gjyqit t'i bënte më të qasshme dhe të kuptueshme për publikun. Nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta me gazetarë, punonjësit e NJIKP-së u ofruan mediave mundësinë për parashtrim të pyetjeve dhe për të marrë informacion praktik. Pas fillimit të gjykimeve në shtator 2021, zëdhënësit shpesh iu përgjigjën pyetjeve të gazetarëve, dhanë intervista rregullisht në televizion dhe radio dhe organizuan informime javore për median nëpërmjet internetit nga dhoma e konferencave për shtyp të DHSK-së.

Fushat për të cilat gazetarët treguan më së shumti interesim më 2021 u përqendruan në parashtrime gjyqësore konkrete, përfshirë vendimet për paraburgim, informacion lidhur me gjykimet e para dhe proceset në vijim, rregullat për vizitë të të paraburgosurve gjatë pandemisë dhe vizitat si i paraburgosur i një të paraburgosuri në Kosovë.

Përkundër kufizimeve për shkak të COVID-19, gazetarët dhe të interesuar të tjerë patën mundësinë të përcillnin seancat publike drejtpërdrejt nga galeria e publikut që ndodhet ngjitur me sallën e gjyqit ose nga qendra për mediat e DHSK-së, që përfshin hapësirë dhe kushte teknike ku gazetarët mund të punojnë dhe të incizojnë videotransmetimin. Videotransmetimi nëpërmjet faqes së internetit të DHSK-së gjithashtu u mundësoi gazetarëve dhe të interesuarve të tjerë të përcillnin proceset në shqip, serbisht ose anglisht.



Zëdhënësjja e DHSK-së Angela Griep gjatë një interviste me Sporazoom, qershor 2021



Zëdhënësi i DHSK-së Majkëll Dojl gjatë një interviste në televizion gjerman, shtator 2021

Veprimtaritë kryesore të komunikimit më 2021

- 650.000 vizita në faqe dhe 75.000 vizitorë në faqen e internetit të DHSK-së
- 11.000 shikime të procesit dhe të videomaterialeve informative në kanalën e DHSK-së në Youtube
- 6 intervista dhe 2 artikuj nga Kryetarja dhe Administratorja të botuara në 10 organe mediatike
- 310 pyetje nga mediat morën përgjigje dhe 5 intervista u dhanë nga zëdhënësit
- 14 informime javore për median të mbajtura në internet


VEPRIMTARITË KRYESORE TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA 2021



PROCESET NË KRYERJE E SIPËR
NË **4 ÇËSHTJE** KU PËRFSHIHEN
8 TË AKUZUAR



GJYKIMET NË VIJM
NË **2 ÇËSHTJE**



67 SEANCA PUBLIKE TË MBAJTURA
DHE TË TRANSMTUARA NË
INTERNET NË **3 GJUHËT** E GJYKATËS



+70.000 SHIKIME TË
FAQEVE TË TRANSMETUARA



20 DËSHMITARË
DËSHMUAN



AFRO 800 VENDIME DHE URDHRA
TË LËSHUARA NGA GJYKATËSI I
PROCEDURËS PARAPRAKE,
TRUPI GJYKUES DHE GJYKATËSIT



895 DOKUMENTE QË PËRFSHIJNË
MBI 12.000 FAQE TË PËRKTHYERA
NË 2021



30 VIKTIMA TË PRANUARA
PËR PJESËMARRJE NË PROCES
NË TRI PREJ ÇËSHTJEVE



+ 500 PERSONA NË KOSOVË
MORËN PJESË NË AKTIVITETET E
INFORMACIONIT PUBLIK PËR GJYKATËN

2.3 | Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

Që nga krijimi i saj, DHSK-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme në nisjen dhe mbajtjen e dialogut me njerëzit në Kosovë dhe rajon, duke punuar në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile. Me mbështetjen zemërgjerë të qeverisë zvicerane nga fillimi i vitit 2018, DHSK-ja ka zbatuar një program solid për komunikim dhe ndërgjegjësim që përfshin krijimin dhe transmetimin e videomaterialeve dhe informacionit grafik lidhur me gjykatën, dhe ka organizuar aktivitete me publikun e gjerë, të rinjtë, përfaqësues të OJQ-ve, avokatë dhe të tjerë në komunitete në mbarë Kosovën.

Takimet ndërvepruese për komunikim dhe ndërgjegjësim u përshtaten audiencës dhe u japin mundësinë njerëzve të ngrenë shqetësime, parashtrojnë pyetje dhe të marrin përgjigje nga përfaqësuesit e DHSK-së. Për shkak të rrethanave të krijuara nga COVID-19, këto aktivitete filluan të mbaheshin në internet në mars 2020 dhe ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim shtoi krijimin dhe transmetimin televiziv të materialeve filmike informuese lidhur me gjykatën.

Që nga nisja e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, janë mbajtur 99 aktivitete në çdo pjesë të Kosovës me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mbi 2.200 pjesëmarrësve. Më 2021, u organizuan 26 aktivitete – me prani fizike dhe në internet – me OJQ-të, përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarë, studentë dhe avokatë nga komuna të ndryshme të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë, Shtërpcë, Kllokot, Reçan, Viti, Ropotovë, Gorazhdec, Llapllasellë, Kufcë e Epërme, Partesh). Pas pezullimit të aktiviteteve me prani fizike për shkak të COVID-19, këto aktivitete rifilluan deri në njëfarë mase në shtator 2021.

DHSK-ja nxjerr fletinformacione dhe fletushka që shpërndahen gjatë aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim. Ato mbulojnë tema si “Një vështrim i shkurtë për DHSK-në”, Mbrojtja, Zyra e Prokurorit të Specializuar, Pjesëmarrja e Viktimave, Drejtuesit dhe Gjykatësit, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim dhe

Avokati i Popullit i DHSK-së. Më 2021 dolën disa fletinformacione të reja të përditësuara pas një periudhe dinamike të zhvillimeve të reja.

Krahas këtyre aktiviteteve, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së krijon materiale filmike me përmbajtje dhe informacion grafik që kanë për qëllim t'i japin publikut të gjerë informacion lidhur me gjykatën dhe t'u përgjigjen pyetjeve dhe shqetësimeve më të shpeshta të njerëzve. Më 2021, DHSK-ja krijoi një material filmik lidhur me pjesëmarrjen e viktimave dhe katër materiale filmike bazuar në pyetjet më të shpeshta që parashtrohen gjatë aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim. Materialet filmike informuese lidhur me mandatin e DHSK-së, pjesëmarrjen e viktimave dhe masat mbrojtëse të dëshmitarëve u transmetuan 407 herë në televizionet në Kosovë gjatë kohës së shikueshmërisë më të lartë dhe u shikuan mijëra herë në faqen e internetit të DHSK-së dhe kanalën në YouTube.

Që nga qershori 2021, DHSK-ja raporton mbi aktivitetet e saj për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe me mediat me anë të një buletini që u jepet palëve të interesuara.

Në maj 2021, DHSK-ja autorizoi kryerjen e një ankete të opinionit publik lidhur me dijeninë, perceptimin dhe mendimet e njerëzve në Kosovë për DHSK-në dhe ZPS-në. Anketimi që filloi pas fillimit të proceseve dhe pas fillimit të fazës së dytë të aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së, tregoi një rritje të dijenisë dhe të të kuptuarit të përgjithshëm prej njerëzve lidhur me institucionet dhe aspektet e komunikuar shpesh gjatë aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim, materialet informuese dhe mesazhet kyçe. Të pyetur se çfarë presin lidhur me punën dhe profesionalizmin e DHSK-së dhe ZPS-së (mbrojtjen e dëshmitarëve, respektimin e të drejtave të akuzuarit, përgjegjësinë penale individuale, pavarësinë e gjykatës), pikëpamjet e një numri të madh të anketuarish përputhen me këto mesazhe.

2.4 | Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjeti i Informimit të Gjykatës

Më 2021, DHSK-ja vazhdoi të këshillohej rregullisht me OJQ-të nga Rrjeti i Informimit të Gjykatës (RRIGJ), një forum i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia që ofrojnë komente dhe sugjerime të vjera për mënyrën se si gjykata mund të përmirësojë programin për komunikim dhe ndërgjegjësim. Ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim mbajti një numër të shtuar të aktiviteteve me RRIGJ-në – në internet dhe me prani fizike – përfshirë katër takime këshilluese me rrjetin dhe një numër të takimeve bilaterale. Komentet e anëtarëve të RRIGJ-së ndihmuan konsiderueshëm formulimin e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe të strategjisë së përgjithshme të komunikimit të DHSK-së, konkretisht duke i

thjeshtuar mesazhet kryesore dhe duke intensifikuar angazhimin me median në Kosovë. Në qershor 2021, Prokurori i Specializuar dhe Administratorja patën një takim në Internet me RRIGJ-në, për t'u dhënë atyre një përditësim, përkatësisht për aktivitetet e ZPS-së lidhur me proceset gjyqësore dhe me funksionet mbështetëse gjyqësore të Zyres Administrative për DHSK-në. Gjithashtu, Kryetarja dhe Administratorja filluan vizitën e tyre në Kosovë në shtator me një takim jozyrtar me anëtarë të RRIGJ-së për të diskutuar perceptimin publik të DHSK-së dhe për të dëgjuar sugjerime rreth programit të DHSK-së për komunikim dhe ndërgjegjësim.



Administratorja Fidelma Donlon dhe Prokurori i Specializuar Xhek Smith gjatë një takimi në Internet me OJQ-të e Rrjetit të Informimit të Gjykatës, 23 qershor 2021

Veprimtaritë kryesore të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim

- 99 aktivitete u mbajtën që nga viti 2018 (viti i fillimit të Programit të DHSK-së për komunikim dhe ndërgjegjësim) në komunitete në mbarë Kosovën, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mbi 2.200 pjesëmarrësve.
- 26 takime për komunikim dhe ndërgjegjësim u mbajtën më 2021 (me prani fizike dhe në internet) me OJQ-të, përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarë, studentë, juristë dhe avokatë nga komuna të ndryshme të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë, Shtërpçë, Klllokot, Reçan, Viti, Ropotovë, Gorazhdac, Llapllasellë, Kufçë e Epërme, Partesh).
- Bazuar në anketimet e kryera pas aktiviteteve, 91% e pjesëmarrësve konsideruan si informues aktivitetin për komunikim dhe ndërgjegjësim dhe 85% e tyre dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitete të tjera për komunikim dhe ndërgjegjësim në të ardhmen.
- Në vitin 2021 dolën katër materiale filmike të reja që mbulonin pyetje që njerëzit parashtronë më së shpeshti gjatë aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim. Doli një material i ri filmik lidhur me pjesëmarrjen e viktimave në një rën prej çështjeve gjyqësore para DHSK-së. Dolën tri informacione grafike lidhur me mandatin e DHSK-së dhe se si gjykata mundëson gjykime të drejta dhe të paanshme.
- Materiale filmike informuese mbi pjesëmarrjen e viktimave, masat mbrojtëse për dëshmitarë në sallë të gjyqit, mandati i DHSK-së dhe tema të tjera u transmetuan 407 herë në vitin 2021 në televizionet në Kosovë dhe u shikuan mijëra herë në faqen e internetit të DHSK-së dhe kanalin në YouTube në shqip, serbisht dhe anglisht.
- Bazuar në një anketë të kryer në maj 2021, 59% të qytetarëve konsideruan se janë të informuar shumë mirë ose në një farë mase të informuar për DHSK-në, një përmirësim i konsiderueshëm krahasuar me anketat e mëparshme.

2.4 | Informacioni publik mbi DHSK-në

Faqja e internetit e DHSK-së është një burim autentik i disponueshëm në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte për këdo që është i interesuar të mësojë më shumë rreth gjykatës, punës së saj dhe proceseve gjyqësore që po kryhen. Ajo përmban informacion për të gjithë personat e interesuar, anëtarë të publikut, gazetarë, hulumtues, avokatë, apo persona që dëshirojnë të paraqesin kërkesë për pjesëmarrje si viktimë në gjykime. Në faqen e internetit, personat e interesuar mund të shohin përditësime të drejtpërdrejta nga gjykimet, të ndjekin lajmet më të fundit të DHSK-së, të shohin kalendarin e gjykatës, të përcjellin seancat gjyqësore, të gjejnë informacione përmbledhëse për çështjet gjyqësore, të kërkojnë në dokumentacionin publik ose të mësojnë më shumë për mënyrën e funksionimit të gjykatës. Në vitin 2021, faqja e internetit e DHSK-së u vizitua nga më shumë se 75.000 persona, nga të cilët 80% ishin vizitorë për herë të parë.

Gjatë vitit 2021, në faqen e internetit të DHSK-së u videotransmetuan 67 seanca publike, njëkohësisht në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Faqja e

transmetimit të seancave në internet dhe faqet me informacion mbi çështjet gjyqësore të DHSK-së, përfshirë përditësimet e drejtpërdrejta të informacionit, ishin më të ndjekurat, me më shumë se 120.000 shikime në vitin 2021; nga të cilat rreth 70.000 shikime të faqes së transmetimit të seancave dhe rreth 50.000 shikime të faqes së informacionit për çështjet gjyqësore dhe përditësimet e informacionit.

Në vitin 2021, DHSK-ja rriti ndjeshëm sasinë dhe larminë e përmbajtjes në kanalin e saj në YouTube, me incizime të të gjitha seancave publike, incizime të informimeve javore për median dhe video të reja informative dhe ndërgjegjësuese me përgjigje për pyetjet më të shpeshta. Videot në kanalin e DHSK-së në YouTube u shikuan më shumë se 11.000 herë në vitin 2021, ku deklarata hyrëse e Prokurorit të Specializuar në gjykimin e parë ishte dhe videoja më e ndjekur nga shikuesit, me 160 orë.



Zëdhënësja e DHSK-së në videoklipin për pyetjet më të shpeshta



Zëdhënësi i DHSK-së në videoklipin për pyetjet më të shpeshta

3 | Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

Avokati i Popullit i DHSK-së është i pavarur në monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, pasi ofron një mekanizëm më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me këto institucione.



Avokati i Popullit Pietro Spera

Avokati i Popullit i DHSK-së është Pietro Spera, gjykatës italian, i cili u emërua në këtë post në maj të vitit 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit përshkruhen hollësisht në amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Që prej krijimit të saj, në Zyrën e Avokatit të Popullit janë paraqitur 18 ankesa dhe për 17 prej tyre shqyrtimi ka përfunduar.

Në vitin 2021, Avokatit të Popullit iu paraqitën pesë ankesa. Për katër nga këto ankesa ka përfunduar procesi i shqyrtimit dhe njëra është ende në proces shqyrtimi.

Tri prej ankesave u gjykuan të papranueshme me arsyetimin se ankuesit nuk kishin paraqitur argumente të mjaftueshme ose nuk kishin vërtetuar se ankesat kishin lidhje me DHSK-në ose ZPS-në. Të gjithë ankuesve iu komunikua rezultati i ankesave dhe vendimet përkatëse, së bashku me arsyetimin e plotë të vendimit.

Ankesa e katërt lidhej me një pretendim për shkelje të të drejtave themelore të ankuesit nga Prokurori i Specializuar dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake i Dhomave të Specializuara. Ankesa kundër Prokurorit të Specializuar u hodh poshtë në bazë të rregullës 29(3)(e) të Rregullores, pasi nuk ishte dorëzuar brenda gjashtë muajsh nga data e shkeljes së pretenduar dhe nuk ishte demonstruar arsye e vlefshme. Ankesa kundër Gjykatësit të Procedurës Paraprake u hodh poshtë në bazë të rregullave 29(1) dhe 29(3)(a) të Rregullores, sipas të cilave Avokati i Popullit nuk ndërhyr në çështje gjyqësore apo procese të tjera ligjore në DHSK, përveç në raste vonesash të paarsyeshme.


Në fillim të vitit 2021, Avokati i Popullit përfundoi hetimin administrativ të një ankese të paraqitur më 2020. Në këtë rast, ankuesi pretendonte se Administratorja i kishte shkelur atij të drejtat themelore sepse në shpalljen e një vendi të lirë pune thuhej se kandidatët për punësim duhet të përmbushnin kushtin e një nënshtetësie të caktuar (nga shtetet e BE-së ose shtetet e treta kontribuese). Avokati i Popullit doli në përfundimin se procedurat e përzgjedhjes dhe rekrutimit të zbatuara nga Administratorja ishin të ligjshme dhe në përputhje me kornizën e pajtuar midis BE-së dhe Kosovës, e zbatueshme në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, më konkretisht neneve 8, 14 dhe 1(1) të Protokollit 12 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Më 7 maj 2021, Avokati i Popullit publikoi në faqen e internetit të DHSK-së raportin me konstatimet e tij.

Në kuadër të funksionit të tij monitorues, Avokati i Popullit pati shkëmbime konstruktive gjatë gjithë vitit me DHSK-në dhe ZPS-në me qëllim sigurimin e respektimit të përpiktë të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Në veçanti, Avokati i Popullit bashkëpunoi me Zyrën Administrative dhe Njësinë e Paraburgimit në kuadër të pandemisë COVID-19 dhe ndikimit të saj në objektin e paraburgimit.

Në tetor 2021, Avokati i Popullit kreu një inspektim fizik të objektit të paraburgimit të DHSK-së. Gjatë këtij inspektimi, Avokati i Popullit u informua për të gjithë të paraburgosurit dhe u takua privatisht me shtatë nga tetë prej tyre. Një nga të paraburgosurit e refuzoi kërkesën për takim privat. Pas inspektimit, Avokati i Popullit i paraqiti një raport Kryetares dhe Administratores.

Pavarësisht nga ndikimi i COVID-19, Zyra e Avokatit të Popullit e vazhdoi gjatë gjithë vitit punën në kuadër të programit për informim dhe ndërgjegjësim. Me ndihmën e Njësisë për Informim dhe Komunikim me Publikun brenda Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në aktivitetet ndërgjegjësuese me shoqërinë civile në rajon, që u zhvilluan përmes platformave në internet.

Në prill 2021, Avokati i Popullit kreu një takim kortezie në internet me Avokatin e Popullit të Kosovës i cili sapo ishte emëruar.



4 | Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore siguron mbështetjen e nevojshme juridike dhe operative për DHSK-në dhe ZPS-në përmes zyrave dhe njësive të veta, të cilat janë: Njësia për Administrimin e Gjykatës, Njësia e Përkthimit, Zyra e Mbrojtjes, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njësia e Paraburgimit.

Viti 2021 shënoi arritje madhore me fillimin e gjyqësorëve në DHSK për dy çështje gjyqësore. Me fillimin e këtyre gjyqësorëve u aktivizuan të gjitha shërbimet për mbështetjen gjyqësore të DHSK-së.

Ndër to përfshihen mbështetja për dëshmitarët që japin dëshmi, sigurimi i përfaqësimit të viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe garantimi i kushteve të sigurta të paraburgimit për tetë të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Veç çështjeve gjyqësore që aktualisht janë në fazën e gjykimit, janë edhe dy çështje të tjera në fazën e procedurës paraprake. Njësitë e ndryshme të Seksionit të Shërbimeve Gjyqësore përfshihen në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, sipas funksioneve të tyre përkatëse.

4.1 | Njësia për Administrimin e Gjykatës

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) është përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit të çështjeve gjyqësore, sistemit elektronik të administrimit të gjykatës *Legal Workflow*, dhe programit kompjuterik të transkriptimit Transcend. Sa i takon funksionimit të sallës së gjyqit, NJAGJ-ja është përgjegjëse për përgatitjen dhe administrimin e seancave gjyqësore. Kjo përfshin edhe dhënien e informacionit dhe njohjen me sallën e gjyqit për gjykatësit, dëshmitarët, palët dhe pjesëmarrës të tjerë.

Gjatë vitit 2021, NJAGJ-ja mori, përpunoi, protokolloi dhe shpërndau 1.859 parashtrime me 908 shtojca dhe administroi nxjerrjen e afërsisht 40.000 dokumenteve mes palëve. Nga këto, 1.161 parashtrime dhe shtojca publike u vendosën në bazën të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik, në faqen e internetit të DHSK-së. Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave që Zyra Administrative të riklasifikonte parashtrimet e protokolluara si publike, u riklasifikuan, ripërpunuan dhe shpërndanë 242 parashtrime të protokolluara, në përputhje me urdhrat përkatës.

Sa i takon punës në sallën e gjyqit, u mbajtën 79 seanca gjyqësore. NJAGJ-ja përpunoi dhe shpërndau 352 transkripte publike dhe konfidenciale të këtyre seancave në tri gjuhët zyrtare të DHSK-së. Në dokumentacionin gjyqësor publik u publikuan 174 prej këtyre transkripteve.

Sistemi *Legal Workflow* u përmirësua më tej për t'iu përgjigjur nevojave të palëve. Nga fundi i vitit Zyra Administrative krijoi një grup pune për të testuar dhe për ta zhvilluar më tej sistemin, me qëllim përmirësimin e funksionimit dhe qëndrueshmërisë së tij. Deri në fund të vitit 2021 sistemi kishte 292 përdorues, të cilëve NJAGJ-ja u ofroi 144 trajnime bazë dhe të përparuara për përdorimin e tij. Gjithashtu, njësia ndihmon përdoruesit e programit të transkriptimit, që u mundëson njerëzve të lexojnë tekstin e plotë të seancave gjyqësore.

4.2 | Njësia e Përkthimit

Në vitin 2021, Njësia e Përkthimit vijoi kryerjen e përkthimeve me gojë dhe me shkrim si në selinë e gjykatës, ashtu edhe në kuadër të misioneve.

Gjatë këtij viti, Njësia e Përkthimit përktheu më se 12.000 faqe në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte, si dhe në gjuhë të tjera, në shërbim të efektivitetit të punës dhe funksionimit të papenguar të gjykatës dhe komunikimeve të jashtme të saj. Pjesa më e madhe e kërkesave ishin për përkthime të parashtrimeve të protokolluara në kuadër të çështjeve gjyqësore në DHSK. Në shumë raste, kryesisht sa u takon parashtrimeve të protokolluara themelore, faktori kohë ishte me shumë rëndësi në punën e Njesisë së Përkthimit, pasi materialet duheshin përkthyer brenda afateve të rrepta për shkak të kriterëve procedurale dhe detyrimit për të respektuar të drejtat e të akuzuarve. Ndër projektet e tjera të rëndësishme ishin përkthimi i rregulloreve të brendshme, materialeve të përgatitura nga Avokati i Popullit dhe Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar, si dhe përkthimi i një

larmie materialesh publike ndërgjegjësuese dhe informuese.

Gjithashtu, Njësia e Përkthimit ndihmoi edhe me përkthimin e materialeve të ZPS-së, duke përkthyer konkretisht 1.066 faqe (61 dokumente) nga ose drejt gjuhëve jozyrtare të DHSK-së.

Njësia e Përkthimit ka qenë po aq e ngarkuar me punë edhe në frontin e përkthimit me gojë, duke ofruar shërbime të përkthimit simultan në 75 seanca gjyqësore, si dhe gjatë aktiviteteve në internet dhe në takime të ndryshme me palë të jashtme. Krahas ofrimit të përkthimit me gojë në takimet e organizuara nga njësitë e DHSK-së, personeli i Njesisë së Përkthimit ndihmoi ekipet e mbrojtjes dhe viktimave të shërbimeve të përkthimit me gojë dhe në objektin e paraburgimit sa herë që ishte e nevojshme. Gjithashtu, Njësia e Përkthimit ofroi përkthim me gojë gjatë informimeve javore të DHSK-së për median në internet.

4.3 | Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarave dhe të akuzuarve të cilët nuk zotërojnë ose zotërojnë pjesërisht mjete financiare. Në kuadër të këtij funksioni, ajo administron gjithashtu, së bashku me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, Listën e Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit në DHSK. Në fund të vitit 2021, në listë, e cila gjendet në faqen e internetit të DHSK-së, kishte 215 Mbrojtës, prej të cilëve 111 mbrojtës të specializuar (avokatë mbrojtës), 28 mbrojtës të viktimave dhe 76 të pranuar njëkohësisht edhe si mbrojtës të specializuar, edhe si mbrojtës të viktimave. Procesi i paraqitjes së kërkesave për praninë është ende i hapur.

Megjithëse është neutrale dhe nuk luan kurrfarë roli në procedimet gjyqësore, Zyra e Mbrojtjes u ka ofruar këshillim dhe mbështetje, sipas nevojës, ekupeve të Mbrojtjes në katër çështjet gjyqësore që po procedohen në DHSK. Ajo ka punuar për t'ua bërë sa më të lehtë mbrojtësve të specializuar përfshirjen në sistemin e DHSK-së, përmes bashkëpunimit me njësitë e tjera për të organizuar trajnime mbi përdorimin dhe qasjen në sistemin elektronik të administrimit gjyqësor me fillimin e punës së tyre si mbrojtës, ofrimit të pajisjeve elektronike, sipas nevojës, si edhe caktimit të mjediseve për zyra në zonën e caktuar për këtë në ndërtesën e DHSK-së.

Ndonëse disa mbrojtës të specializuar dhe ekipet e tyre vazhduan të merrnin pjesë në procedurat gjyqësore përmes mjeteve elektronike nga distanca, pati edhe shumë që udhëtuan drejt Holandës për t'u takuar me të akuzuarit dhe për të marrë pjesë fizikisht në seanca. Për të garantuar që ekipet e Mbrojtjes të punonin pa pengesa si dhe për respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë, ZM-ja së bashku me Zyrën e Protokollit ofruan udhëzime dhe mbështetje lidhur me rregullat në fuqi për udhëtimet dhe hyrjen në Holandë në kushtet e pandemisë së COVID-19. Po ashtu, Zyra e Mbrojtjes mori masa për mundësimin e udhëtimeve të mbrojtësve të specializuar dhe anëtarëve të tyre drejt Kosovës.

Në vitin 2021, Zyrës së Mbrojtjes iu paraqit një kërkesë për ndihmë juridike nga një i akuzuar. Pas marrjes së kërkesës, ZM-ja kreu një hetim financiar të hollësishëm në përputhje me Rregulloren për

Ndihmë Juridike dhe i dha informacion Administratorës lidhur me varfërinë e të akuzuarit. Bazuar në këtë informacion, Administratorja miratoi dhënien e kushtëzuar të ndihmës juridike për disa muaj, në pritje të rezultatit të vlerësimit. Gjithashtu, Zyra e Mbrojtjes krijoi një listë me mbrojtës të pavarur, të cilët janë të aftë dhe të gatshëm që, nëse është nevoja dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, t'u ofrojnë ndihmë juridike dëshmitarëve që rrezikojnë të inkriminojnë vetveten gjatë dhënies së dëshmisë, në përputhje me rregullën 151(6) të Rregullores së Procedurës dhe Provave.

Zyra e Mbrojtjes shërben si pika e kontaktit në kuadër të Zyrës Administrative për mbrojtësit e listës dhe ekipet e mbrojtjes lidhur me çdo aspekt që mund të jetë me interes për ta, si për shembull ndihma juridike.

4.4 | Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në DHSK. ZPV-ja u ofron ndihmë dhe këshilla personave që dëshirojnë të marrin pjesë në proces si viktimë, përpunon kërkesat e tyre në mënyrë konfidenciale dhe të sigurt dhe ia dorëzon ato Panelit përkatës për të marrë vendim lidhur me to.

Viktimat që marrin pjesë në proceset gjyqësore në DHSK gëzojnë të drejta të caktuara, ndër të cilat të drejtat për njoftim, pranim dhe zhdëmtim. Mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore, t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, t'u përgjigjet parashtrimeve të palëve, si dhe i mban viktimat të informuara gjatë të gjithë procesit gjyqësor. Mbrojtësi i viktimave merr mendimet e viktimave, dëgjon shqetësimet e tyre, dhe i sjell ato në vëmendje të gjykatësve.

Pas pranimit të tyre si viktimë pjesëmarrëse në proceset para DHSK-së, ZPV-ja siguroi gjithashtu që viktimat e pranuar të përfaqësohen siç duhet, përfshirë edhe nëpërmjet mbajtjes së listës me 104

mbrojtës të kualifikuar të miratuar për të përfaqësuar viktimat në proceset para DHSK-së për vitin 2021. ZPV-ja administron gjithashtu sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse.

Në vitin 2021, me rekomandim të ZPV-së, Administratorja caktoi dy mbrojtës të viktimave: një në çështjen e z. Mustafa dhe një në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerë.

Që prej vitit 2020, statusi i viktimës pjesëmarrëse u është miratuar 30 personave në tri çështje gjyqësore para DHSK-së: një në çështjen kundër z. Shala, nëntë në çështjen kundër z. Mustafa dhe 20 në çështjen kundër z. Thaçi dhe të tjerë.

Gjatë vitit 2021, gjashtë nga personat kërkesat e të cilëve për pjesëmarrje si viktimë në çështjen Thaçi dhe të tjerë u refuzuan, e apeluar vendimin me ndihmën e një mbrojtësi kujdestar. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi vendimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake dhe përsëri ua refuzoi statusin e viktimave pjesëmarrëse.

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave vazhdoi aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimin, kryesisht përmes internetit, në përpjekje për të kontaktuar me viktimat e mundshme dhe organizatat që i përfaqësojnë ato. Ndër këto aktivitete ishin tryeza të rrumbullakëta me gazetarët dhe shoqërinë civile dhe krijimi e publikimi i videomaterialeve shpjeguese për procesin e paraqitjes së kërkesës për praninë si viktimë

pjesëmarrëse, një prej të cilave u fokusua veçanërisht në çështjen kundër z. Mustafa. Videot u transmetuan në kanalet televizive në Kosovë dhe Serbi.

Në vitin 2021, 30 personave iu miratua statusi i viktimës pjesëmarrëse në DHSK.

4.5 | Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe, sipas rastit, të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët.

Në vitin 2021, me fillimin e gjyqimit të dy çështjeve në DHSK dhe të dëshmimeve të para të dëshmitarëve, puna e ZMMD-së u intensifikua. Njësia ofroi një varg shërbimesh të shumëllojshme për mundësimin e paraqitjes së sigurt dhe në kohë të 20 dëshmitarëve, 10 para Trupit Gjyqësor I dhe 10 para Trupit Gjyqësor II. Ndër to ishin informimi i dëshmitarëve përpara udhëtimit lidhur me shërbimet dhe ndihmën që do t'u ofrohej, dhe lidhur me aspekte të sigurisë, mirëqenies, udhëtimit, fjetjes dhe pagesës së shpenzimeve.

ZMMD-ja kujdeset për përgatitjen e të gjitha aspekteve logjistike të udhëtimit dhe qëndrimit të dëshmitarëve në vendin ku ndodhet selia e gjykatës. Gjatë udhëtimit, nëse është e nevojshme, dëshmitarët shoqërohen nga punonjësit e ZMMD-së. Kur mbërrijnë në gjykatë, punonjësit e ZMMD-së i njohin dëshmitarët me planimetrinë e sallës së gjyqit, sistemet që përdoren aty, dhe dhomat e pritjes për dëshmitarët.

Gjatë tërë kohës së qëndrimit të dëshmitarëve në Holandë, personeli i njësies është në dispozicion të tyre 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, për t'u ofruar mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme. Gjithashtu, dëshmitarëve u ofrohet mbështetje për të marrë ndihmë mjekësore, psikologjike dhe çdo ndihmë tjetër që është e nevojshme për të dëshmuar para DHSK-së. Përveç kësaj, para se dëshmitarët të japin dëshmi, psikologë të specializuar dhe personeli mbështetës kryejnë vlerësime lidhur me cenueshmërinë e tyre, si dhe u ofrojnë mbështetje psikosociale para dhe pas dëshmisë. Pasi përfundimit të dhënies së dëshmisë, njësia mundëson kthimin e sigurt të dëshmitarëve në shtëpi dhe zbaton një program për marrjen e mendimeve të dëshmitarëve për të vlerësuar ndikimin që ka pasur tek ata përvoja e dhënies së dëshmisë si dhe mendimet e tyre lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Gjithashtu, në vitin 2021, Trupi Gjyqësor I miratoi për dy dëshmitarë ofrimin e ndihmës në sallën e gjyqit nga punonjësit e ZMMD-së që flisnin gjuhën e dëshmitarëve si dhe praninë e një psikologu të ZMMD-së. ZMMD-ja forcoi më tej kapacitetet dhe aftësitë e saj operative për mbrojtjen efektive të personave në rrezik të lartë, në rast nevojë, në bashkëpunim me homologët nga vendi dhe ata ndërkombëtarë.

4.6 | Njësia e Paraburgimit

Njësia e Paraburgimit drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet në mjediset e një burgu holandez në Hagë. Njësia e Paraburgimit siguron që të gjithë të paraburgosurit të jenë të mbrojtur dhe të sigurt dhe garanton respektimin e plotë të dinjitetit dhe të drejtave të tyre në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit të DHSK-së, rregulloret, praktikat më të mira dhe të gjitha standardet ndërkombëtare përkatëse. I paraburgosuri i tetë u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në prill 2021.

Me shtimin e numrit të seancave dhe fillimin e gjyqësorëve në vitin 2021, Njësia e Paraburgimit vazhdoi të përshtaste punën dhe të zbatonte zgjidhje teknologjike për lehtësimin e pjesëmarrjes së të paraburgosurve në proceset gjyqësore, duke u mundësuar qasje në seancat gjyqësore nga distanca.

Në kuadër të angazhimit të DHSK-së për t'u siguruar të paraburgosurve kohën dhe mjetet e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre në pajtim me praktikat më të mira në këtë fushë, në mars 2021 filloi funksionimi i Sistemit për Shkëmbimin e Mbrojtur Elektronik të të Dhënave, i cili u mundëson të paraburgosurve dhe mbrojtësve të tyre të shkëmbejnë dokumente lidhur me çështjet gjyqësore.

Sigurimi i kontaktit të njëmendtë të të paraburgosurve me familjet e tyre, pavarësisht nga kufizimet për shkak të pandemisë, vazhdoi të ishte në fokusin e DHSK-së. Pas fushatës së suksesshme të vaksinimit në objektin e paraburgimit dhe këshillimit me mjekun e paraburgimit, në mes të korrikut 2021 u bë i mundur rifillimi gradual i vizitave familjare, fillimisht me anëtarët e familjes së ngushtë. Masat për lejimin e një numri më të madh të thirrjeve telefonike dhe vizitave virtuale mbetën të njëjta edhe pas rifillimit të të gjitha vizitave familjare dhe të vizitave nga vizitorë të tjerë personalë në objektin e paraburgimit në shtator 2021. Vizitat nga mbrojtësit vazhduan njësoj gjatë gjithë kohës.

Gjatë vitit 2021 u kryen disa vizita dhe inspektime të pavarura për të siguruar respektimin e të drejtave të paraburgosurve. Në shtator Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) kreu vizitën e parë të pavarur fizike në objekt, nga dy inspektime gjithsej deri në fund të vitit 2021. Inspektimet e KNKK-së kanë për qëllim të vlerësojnë përshtatshmërinë e kushteve në të cilat mbahen të paraburgosurit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të paraburgimit, siç parashihet edhe në kornizën ligjore të DHSK-së. Gjatë këtyre vizitave, KNKK-ja bëri takime individuale me të burgosurit e DHSK-së. Në tetor, Avokati i Popullit i DHSK-së kreu inspektimin e tij të parë fizik në objekt për të vlerësuar kushtet e paraburgimit në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe Provave.

Me rifillimin e vizitave personale familjare në korrik 2021, Njësia e Paraburgimit administroi më shumë se 200 vizita nga anëtarët e familjeve në objektin e paraburgimit të DHSK-së.



Objekti i paraburgimit i DHSK-së

5 | Seksioni i Administratës


Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes njësive të saj, të cilat janë: Njësia e Burimeve Njerëzore, Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme, Njësia e Sigurisë, Njësia e Financave dhe Buxhetit, dhe Njësia e Prokurimit.

Në vitin 2021, puna e këtij seksioni u përqendrua në përgatitjen e sallës së gjyqit për proceset gjyqësore dhe sigurimin e zbatimit të masave për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19 në të gjitha mjediset e gjykatës dhe gjatë udhëtimeve për arsye pune. Gjithashtu, ky seksion bëri përgatitjet për rikthimin e të gjithë punonjësve në gjykatë, duke garantuar mjedis pune të sigurt për ta.

Një pjesë e mirë e punës së Seksionit të Administratës u përqendrua në krijimin, zbatimin dhe testimin e një sistemi kompjuterik të quajtur *Enterprise Resource*

Planning (ERP), të cilin DHSK-ja e bleu në fund të vitit 2020. Sistemi ERP është një paketë programesh kompjuterike për administrimin e organizimit të punës, i përshtatur për proceset e punës financiare, buxhetore, të pagave, si dhe për administrimin e personelit dhe të pasurive të DHSK-së. Në vitin 2021 u bë përparim në përshtatjen e programit për proceset buxhetore dhe financiare të punës.

Shefi i Seksionit, në cilësinë e personit të kontaktit kundër mashtrimeve, së bashku me audituesen e brendshme dhe një punonjës të seksionit të administratës, morën pjesë në një seminar për përgatitjen e trajnerëve kundër mashtrimit, organizuar nga Shërbimi i Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme (IPJ) dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit. Pas këtij seminari, pjesëmarrësit ofruan tre trajnime ndërgjegjësuese kundër mashtrimit për punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së.



5.1. | Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ofron mbështetje dhe këshilla për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. Gjatë vitit 2021, kjo njësi vazhdoi kryerjen e detyrave të saj përmes ofrimit të ndihmës në procesin e rekrutimit dhe administrimit dhe këshillimit të punonjësve për një sërë çështjesh të personelit – që nga kompensimet dhe përfitimet, e deri tek aspekte të mirëqenies dhe sigurimit shëndetësor; u ofroi mbështetje punonjësve dhe kuadrit udhëheqës gjatë procesit të vlerësimit të punës së punonjësve; dhe organizoi trajnime dhe aktivitete të tjera për zhvillimin personal dhe profesional të punonjësve.


Gjatë vitit 2021 u publikuan dy Ftesa për Aplikime për vende pune dhe një ftesë për praktikë profesionale. Në kuadër të këtyre ftesave u morën dhe shqyrtuan gjithsej 2.277 kërkesa nga 1.013 aplikantë (425 femra dhe 588 meshkuj). Gjithashtu, në vijim të ftesës për praktikë profesionale u morën 289 kërkesa nga 101 aplikantë (71 femra dhe 30 meshkuj). Numri i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së, marrë së bashku, u rrit nga 244 më 31 dhjetor 2020 në 268 punonjës më 31 dhjetor 2021. Nga 202 punonjës në DHSK, 97 ishin femra dhe 105 meshkuj dhe nga 66 punonjës në ZPS, 25 ishin femra dhe 41 meshkuj. Në vitin 2021 u emëruan gjithsej 65 punonjës të rinj. Numri i punonjësve të emëruar përmes autoriteteve shtetërore mbeti i pandryshuar, me 10 punonjës nga gjashtë shtete anëtare të BE-së (Bullgaria, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia dhe

Malta) si dhe dy shtete të treta kontribuese (Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Njësia vazhdoi të siguronte që anëtarët e paneleve përzgjedhës të merrnin udhëzimet e duhura lidhur me proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve në DHSK dhe ZPS, dhe t'u ofrohej mbështetja e duhur në marrjen e vendimeve me bazë informacionin në cilësinë e anëtarëve të panelit.

NJBNI-ja po ashtu u ofroi punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së kurse për formim dhe zhvillim profesional për tema si udhëheqja dhe administrimi, parandalimi ngacmimit psikologjik dhe seksual, drejtimi i punës dhe teknologjia e informacionit. Në kuadër të detyrave të saj, gjatë vitit 2021 NJBNI-ja vijoi të ofronte shërbime për mirëqenien dhe këshillim psikologjik të punonjësve. Në bashkëpunim me Kabinetin e Administratores, NJBNI-ja përditësoi kornizën rregullatore të burimeve njerëzore duke rishikuar rregulloren e personelit, ku përfshiu disa ndryshime të rëndësishme.


Gjithashtu, njësia luajti një rol të rëndësishëm për mbështetjen e punonjësve gjatë pandemisë. Personi i kontaktit për COVID-19 u dërgoi rregullisht punonjësve përditësime lidhur me masat në shtetin pritës, programin e vaksinimit dhe certifikatat digjitale. Punonjësve iu ofruan këshilla se çfarë duhet të bënin në rast infektimi ose kontakti me persona të infektuar, si dhe lidhur me masat kufizuese për udhëtimet.

Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së



Përfaqësimi i punonjësve në DHSK dhe ZPS sipas shteteve

31 Dhjetor 2021



5.2 | Njësia e Teknologjisë së Informacionit

Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) ofron shërbime të sigurta informatike dhe audiovizuale në mbështetje të punës së DHSK-së dhe veprimtarisë në sallën e gjyqit, si në selinë e DHSK-së ashtu edhe nga distanca.

Viti 2021 shënoi një arritje të madhe për DHSK-në dhe NJTI-në me fillimin e gjykimeve të para në shtator dhe tetor 2021, me gjithë kufizimet për shkak të COVID-19. Nga pikëpamja teknike, për proceset gjyqësore nevojiteshin videolidhje shtesë me objektin e paraburgimit dhe sallën e gjyqit, për të mundësuar pjesëmarrjen nga distanca të ekipeve të Mbrojtjes dhe të palëve të tjera. NJTI-ja përfshiu në infrastrukturën e sallës së gjyqit një sistem të integruar për transmetime të njëkohshme, të sigurta, të pandërprera dhe në kohë reale, në shërbim të proceseve gjyqësore.

Seancat publike u transmetuan në faqen e internetit të DHSK-së në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte, me një vonesë kohore për të garantuar masat mbrojtëse për dëshmitarët.

Për të siguruar veprimtari të pandërprera dhe të sigurta në sallën e gjyqit edhe në të ardhmen, filloi puna për zëvendësimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe të rrjetit dhe pajisjeve audiovizuale që po i afroreshin afatit përfundimtar të përdorimit. Kjo punë filloi pa shkaktuar asnjë ndërprerje në proceset gjyqësore. Gjithashtu, u zbatuan masa të mëtejshme për mbrojtjen e informacionit dhe të infrastrukturës, për të rritur më tej kontrollin mbi informacionin.

Në mars 2021, DHSK-ja vuri në funksion një sistem për shkëmbimin e mbrojtur të materialeve elektronike ndërmjet mbrojtësve dhe të paraburgosurve, i cili mundëson shkëmbimin e dokumenteve të çështjes përmes skedarëve të përbashkët elektronikë në rrjetin e DHSK-së.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 NJTI-ja përgatiti një numër pajisjesh elektronike për të mundësuar lidhjen me dëshmitarët nga distanca, të përshtatshme për t'u përdorur gjatë misionëve. Falë tyre, lidhja me sallën e gjyqit mund të vendoset virtualisht nga kudo në botë, përmes internetit ose rrjetit të të dhënave mobile. Këto pajisje mbahen në kuti në madhësi të njëjtë me valixhet që lejohen të merren me vete në avion, çka zvogëlon rrezikun e humbjes së tyre apo të ndërhyrjeve të jashtme në to.

Gjatë gjysmës së parë të vitit, NJTI-ja filloi zbatimin dhe testimin e sistemit të programit kompjuterik *Enterprise Resource Planning* për procese pune administrative dhe financiare.

Sa i takon pajisjeve kompjuterike, njësia ngriti dhe vuri në funksionim dy qendra të të dhënave për të forcuar më tej ruajtjen paralele të të dhënave të sistemeve kryesore, të cilat rrisin kapacitetet për rikuperimin e të dhënave dhe vijimësinë e punës në raste defektesh madhore, si edhe sigurojnë veprimtarinë e pandërprerë, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, të Njesisë së Sigurisë dhe të objektit të paraburgimit.

Të paraburgosurit mund të marrin pjesë në seancat gjyqësore nga objekti i paraburgimit i DHSK-së njësoj si të ishin në sallën e gjyqit, me përkthimet përkatëse dhe masat mbrojtëse të miratuara.

5.3 | Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për realizimin efikas dhe të efektshëm të shërbimeve mbështetëse për DHSK-në dhe ZPS-në. Kjo përfshin administrimin e pasurive të paluajtshme së bashku me autoritetet përkatëse të shtetit pritës, mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ndërtimet, si dhe planifikimin e hapësirave të punës me synimin e sigurimit të një mjedisi pune cilësor për punonjësit dhe vizitorët e institucionit.


Njësia është gjithashtu përgjegjëse për shërbime të tilla si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastrimi. Ajo administron gjithashtu shërbimin e protokollit, postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin, udhëtimet dhe logjistikën, si dhe punon ngushtësisht me Njësinë e Sigurisë dhe atë të Protokollit.

Në vitin 2021, njësia vazhdoi të ishte në krye të punës për zbatimin e masave në lidhje me pandeminë e KOVID-19 të cilat lidheshin me administrimin e mjediseve të ndërtesave, në përputhje me udhëzimet e shtetit pritës.

Masat për zbutjen e rrezikut dhe përshtatja e mjediseve ishin me rëndësi kyçe për mbajtjen e seancave publike që u ndoqën nga anëtarë të publikut në galerinë publike dhe nga përfaqësues të mediave në dhomat e përgatitura posaçërisht për mediat.

Në maj 2021, NJAOSHP-ja filloi një projekt afatgjatë bashkëpunimi me Agjencinë Qeveritare të Pasurive të Paluajtshme të Holandës për hartimin e një kontrate të re për mirëmbajtjen e mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, e cila do të hyjë në fuqi në maj 2023. Kontrata e mirëmbajtjes mbulon të gjitha aspektet e administrimit dhe sigurisë së ndërtesës, të teknologjisë së informacionit dhe të sistemeve audiovizuale.

Me fillimin e gjyqimeve, NJAOSHP-ja ka bërë përpjekje që administrimin e mjediseve ta kryejë në një mënyrë që siguron gatishmërinë dhe funksionalitetin e sallës së gjyqit.



5.4 | Njësia e Sigurisë

Njësia e Sigurisë (NJS) kryen një varg shërbimesh të ndryshme në fushën e sigurisë në mbështetje të veprimtarisë së DHSK-së, si dhe punon për ndërgjegjësimin e punonjësve për një sërë rreziqesh në nivel individual dhe organizativ.

Gjatë vitit 2021, krahas përbushjes së përgjegjësië monitoruese dhe këshilluese lidhur me pandeminë e KOVID-19, puna e NJS-së u përqendrua edhe në garantimin e mbështetjes së plotë operative për proceset gjyqësore që kanë filluar. Ndër to ishte edhe trajnimi i punonjësve të rinj për aspekte që lidhen posaçërisht me vendin e punës së tyre. Trajnimet profesionale u kryen me sukses brenda parametrave të kufizimeve të vendosura për shkak të KOVID-19.

Përbushja e detyrimeve ligjore të shtetit prites lidhur me përdorimin dhe sigurinë e ndërtesave u garantua përmes kryerjes me sukses të provës vjetore të gatishmërisë në raste emergjente. Dokumentacioni mbi faktorët që rrezikojnë sigurinë rishikohet dhe përditësohet në mënyrë periodike në përputhje me vlerësimet e NJS-së dhe të autoriteteve përgjegjëse në shtetin prites.

Puna përgatitore u kurorëzua me ofrimin e suksesshëm të shërbimit të sigurisë për shumë pjesëmarrës dhe persona të tjerë në kontekstin e veprimtarisë së plotë gjyqësore. Në përputhje me vendimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake, NJS-ja realizoi dy vizita të njërit prej të paraburgosurve në Kosovë. Këto operacione pune tejet të ndërlikuara u kryen në një afat kohor shumë të shkurtër dhe kërkuan një nivel të lartë bashkëpunimi dhe bashkërendimi me shumë njësi mbështetëse të jashtme. Si punonjësit e përfshirë drejtpërdrejt, ashtu edhe DHSK-ja në tërësi, u përgëzuan për profesionalizmin, efikasitetin dhe frymën e respektit që i karakterizoi këto veprime.

Në vitin 2021, Njësia e Sigurisë realizoi dy vizita të një të paraburgosuri në Kosovë për arsye humanitare, në pajtim me vendimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake.



Masat e kontrollit gjatë hyrjes në gjykatë

5.5 | Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren në administrimin financiar dhe përdorimin e fondeve që i janë akorduar DHSK-së, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe të BE-së, si dhe për zbutjen e rreziqeve financiare për DHSK-në.

Gjatë vitit 2021, Njësia e Financave dhe Buxhetit vazhdoi punën për sigurimin e një administrimi sa më efikas dhe autonom dhe për ndërtimin e një cikli financiar më të qëndrueshëm, me qëllim miradministrimin financiar të fondeve. Për këtë u akorduan burime të konsiderueshme për t'iu përshtatur kushteve të pandemisë si dhe për zbatimin e sistemit *Enterprise Resource Planning*. Veç kësaj, në vitin 2021 Administratorja nxori ose përditësoi katër direktiva administrative dhe NJFB-ja organizoi trajnime të rregullta për punonjësit lidhur me ciklet financiare të DHSK-së dhe ZPS-së. Në sajë të tyre, DHSK-ja ka një bazë të shëndoshë rregullash financiare, procedurash dhe njohurish teknike.

DHSK-ja vazhdoi administrimin e fondeve të akorduara nga BE-ja gjatë vitit 2021, në pajtim me Marrëveshjen e Pestë për Subvencionim, e cila u nënshkrua nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së dhe nga Komisioni Evropian (Marrëveshja e Subvencionimit) për periudhën 15 qershor 2021 - 14 qershor 2023, në shumën 110.279.698 euro, dhe në pajtim me Marrëveshjen e Katërt për Subvencionim, në shumën prej 42.900.000 euro për periudhën 15 qershor 2020 - 14 qershor 2021. Krahas fondeve të akorduara nga BE-ja, DHSK-ja administroi edhe shumën prej 144.700 euro, akorduar nga qeveria zvicerane për aktivitetet e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së në vitet 2020 dhe 2021.

Në vitin 2021, NJFB-ja kreu më shumë se 3.000 veprime financiare në kuadër të angazhimeve buxhetore për pagesat, një pjesë e madhe e të cilave lidheshin me fillimin e proceseve gjyqësore. Në përgjithësi, numri i veprimeve financiare në vitin 2021 ishte më i lartë se në vitin paraardhës.

Gjatë vitit 2021, u përmbyllën me sukses Marrëveshja e Tretë për Subvencionim për periudhën 15 qershor 2018 - 14 qershor 2020 dhe marrëveshja e nënshkruar midis DHSK-së dhe qeverisë norvegjeze në shumën prej 80.000.000 korona norvegjeze si mbështetje për zhvendosjen në mjediset e reja, në zbatimin e të cilave nuk u konstatua asnjë parregullsi. Gjithashtu, u dorëzuan raportet përfundimtare lidhur me Marrëveshjen e Katërt për Subvencionim nga BE-ja për periudhën 15 qershor 2020 - 14 qershor 2021.

Në kuadër të kornizës rregullore të DHSK-së dhe të financimit nga BE-ja, kryhen rregullisht auditime të pavarura dhe verifikime të shpenzimeve si nga auditues të brendshëm ashtu dhe të jashtëm. Në vitin 2021, auditimet dhe verifikimet e shpenzimeve të kryera nuk konstatuan asnjë parregullsi.

NJFB-ja vazhdoi të zhvillonte dhe forconte bashkëpunimin efektiv me Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) me qëllim monitorimin dhe zbatimin efikas të burimeve financiare të DHSK-së.

Në vitin 2021, NJFB-ja siguroi në vijimësi miradministrimin financiar të fondeve të akorduara nga BE-ja dhe Zvicra.

5.6 | Njësia e Prokurimit

Roli kryesor i Njesisë së Prokurimit është sigurimi në kohë dhe me çmimin e duhur i mallrave, shërbimeve apo punimeve të nevojshme për përmbushjen e mandateve të DHSK-së dhe ZPS-së. Duke qenë se prokurimet janë një nga fushat me kornizë rregullatore më të plotësuar në sektorin publik, prokurimet e kryera nga DHSK-ja dhe ZPS-ja janë rregullisht objekt i kontrolleve dhe auditimeve të rrepta.


Më 2021, njësia punoi për të përmirësuar më tej efikasitetin e punës, me qëllim përdorimin sa më efikas të shpenzimeve dhe uljen e përdorimit të burimeve buxhetore për prokurimet për vitet e ardhshme, pa cenuar përmbushjen e mandatit të DHSK-së dhe ZPS-së. Në të njëjtën kohë, u bënë përpjekje të konsiderueshme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të ofruesve të ardhshëm të mallrave dhe shërbimeve për proceset dhe kriteret e tenderimit, si dhe për t'u ofruar sa më shumë kompanive mundësinë për të punuar me DHSK-në dhe ZPS-në, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Në të njëjtën kohë, Njësia e Prokurimit vazhdoi të siguronte pajtueshmërinë me praktikën më të mirë në fushën e prokurimit si dhe për të minimizuar rrezikun

e mospajtueshmërisë me rregullat dhe rregulloret përkatëse të prokurimit, kryesisht me Udhëzuesin Praktik mbi Procedurat e Prokurimit dhe Subvencionimit për Projekte të Jashtme të Financuara nga BE-së – si dokumenti kryesor mbi të cilin mbështeten veprimtaritë e prokurimit të DHSK-së dhe ZPS-së, si dhe rregulloret dhe udhëzuesit e brendshëm.

Gjatë vitit 2021, Njësia e Prokurimit ofroi trajnime për personelin e DHSK-së dhe ZPS-së për të siguruar që administrimi i kontratave dhe proceset e anketimit të tregut të kryhen në mënyrë të njëtrajtshme dhe rigorozë në të gjithë organizatën. Qëllimi i tyre ishte që e gjithë organizata të kishte një qasje me fokus më komercial, të orientuar drejt identifikimit të mundësive për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve dhe për kryerjen e prokurimeve sa më cilësore.

Në vitin 2021, DHSK-ja dhe ZPS-ja përfunduan më shumë se 130 kontrata prokurimi për një numër mallrash dhe shërbimesh me vlerë mbi 13,5 milion euro.



6 | Zyra e Auditimit

Auditimi i brendshëm është pjesë përbërëse e administrimit dhe llogaridhënies institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së. Audituesi i brendshëm kryen auditime të shumta dhe ia raporton konstatimet Administratores. Në punën e vet, audituesi u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe rregullores financiare të BE-së, dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.

Për shkak të pandemisë së KOVID-19, audituesja e brendshme i kreu auditimet nga distanca, në përputhje me planin vjetor të auditimeve. Gjatë vitit 2021, u kryen nëntë auditime me fokus mbi shpenzimet, prokurimet, mbrojtjen e pasurive, rekrutimin, fondin e kursimeve dhe subvencionin e

akorduar nga qeveria zvicerane. Audituesja e brendshme kreu gjithashtu edhe tre auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme. Përveç detyrave të auditimit, audituesja e brendshme u angazhua edhe në trajnimet kundër mashtrimit për punonjësit e organizatës.

Qëllimi i auditimeve nuk është vetëm për të kontrolluar saktësinë e të dhënave dhe respektimin e rregullave, por edhe për të verifikuar përshtatshmërinë e kontrolleve, efikasitetin, ruajtjen e pasurive, dhe shqyrtimin e çdo aspekti që mund të ndikojë negativisht në përmbushjen e objektivave të organizatës.

Integrimi i perspektivës gjimore në DHSK dhe ZPS



Mjedis pune i sigurt dhe gjithëpërfshirës

Drejtuesit e lartë të DHSK-së dhe ZPS-së vazhdojnë të kultivojnë një mjedis pune të sigurt, përkrahës dhe gjithëpërfshirës si dhe mbështesin plotësisht personin e kontaktit për çështje gjinore, si dhe të gjitha veprimtaritë lidhur me integrimin gjinor.

Trajnimi dhe mbështetja

Në përputhje me këtë angazhim të drejtuesve të lartë, sikurse theksohet edhe në Strategjinë Kundër Ngacmimeve të vitit 2019 për parandalimin e ngacmimeve në vendin e punës, dhe në vijim të trajnimit të vitit 2020 “Parandalimi i ngacmimeve - respekti dhe dinjiteti në vendin e punës”, në vitin 2021 u organizua një trajnim tjetër në këtë fushë me temën “Parandalimi i ngacmimit psikologjik dhe seksual”. Deri në fund të vitit 2021, këtë trajnim e kishin kryer 95% e drejtuesve të nivelit të parë dhe të mesëm, anëtarët e Organit Përfaqësues të Punonjësve si dhe një numër i madh punonjësish të DHSK-së dhe ZPS-së.

Gjithashtu, disa punonjës morën pjesë në një seminar njëjavor të organizuar nga BE-ja për personat e kontaktit për çështje gjinore, me qëllim rritjen e njohurive të tyre mbi integrimin gjinor dhe përfshirjen e aktiviteteve me perspektivë gjinore në punën e përditshme të institucionit. Veç kësaj, edhe anëtarët e paneleve të rekrutimit në DHSK dhe ZPS u trajnuan lidhur me ndërgjegjësimin gjinor.

Psikologjia vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në kuadër të përpjekjeve të drejtuesve të lartë të DHSK-së dhe ZPS-së për sigurimin e mbështetjes psikologjike për të gjithë punonjësit. Psikologjia ishte e disponueshme gjatë gjithë vitit për t'u takuar privatisht me punonjësit dhe për t'u dhënë atyre udhëzime dhe këshilla.

Masa proaktive për rritjen e përfaqësimit të grave


Niveli drejtues i DHSK-së dhe ZPS-së vazhdoi të merrte masa për të përmirësuar përfaqësimin e grave në vendet punës në fushën e sigurisë, ku numri i tyre është tradicionalisht i vogël. ZPS-ja identifikoi si problem të theksuar numrin e vogël të grave kandidate për vende pune në njësinë e sigurisë së operacioneve dhe dëshmitarëve. Prokurori i Specializuar dhe ekipi i tij u zotuan ta trajtojnë në mënyrë proaktive këtë çështje për të siguruar rritjen e numrit të grave kandidate për këto vende pune. Një hap i rëndësishëm që u ndërмор ishte përgatitja e një strategjie për informim dhe ndërgjegjësim lidhur me rekrutimin.

Në fillim të pranverës së vitit 2021, ZPS-ja zhvilloi takime me përfaqësues të ambasadave, shefa të njësive të sigurisë në organizatat ndërkombëtare, OJQ dhe kompani shumëkombëshe për të rritur ndërgjegjësimin dhe për t'u shpjeguar punën e njësive të sigurisë së operacioneve dhe dëshmitarëve. Pjesëmarrësve në takime iu kërkua që të shpërndanin përshkrimet e punës për vendet e lira të punës në rrjetet e tyre përkatëse, si dhe të identifikonin dhe nxisnin gratë e interesuara që të aplikonin për ato vende pune.

Falë këtyre përpjekjeve u arritën rezultate të konsiderueshme. Numri i grave kandidate për vende pune në njësinë e sigurisë së operacioneve dhe dëshmitarëve u trefishua. Po ashtu, një numër i madh i grave që paraqitën kërkesë kaluan në fazat e tjera të përzgjedhjes dhe në fund të procesit u rekrutuan dhe kandidatet e para si punonjëse të sigurisë operative.

Hapat e ndërmarrë për përmirësimin e barazisë gjinore në këto vende pune janë pjesë e përpjekjeve të Prokurorit të Specializuar për të zbatuar masa konkrete me synim eliminimin e çfarëdo njëanshmërie apo kufizimi për gratë që pranohen në vende pune në ZPS, dhe për të garantuar që barazia gjinore të jetë faktor kyç që ai dhe institucioni i tij e mbajnë parasysh në punën e tyre.

Përfaqësimi gjinor në DHSK dhe ZPS 31 dhjetor 2021



Dy nga tre drejtuesit e lartë të DHSK-së dhe ZPS-së janë gra. Në 24 panelet e Gjykatës së Apelit të caktuar në vitin 2021, shumica (17) kishin dy gjykatëse dhe një gjykatës, dhe të gjithë panelet u drejtuan nga një gjykatëse. Gjithashtu, ka barazi gjinore sa u takon kryegjykatësve të dy trupave gjykues, ku njëri drejtohet nga gjykatëse dhe tjetri nga gjykatës.

Raporti i përgjithshëm gjinor në DHSK dhe ZPS ndër punonjësit e rinj është rritur ndjeshëm që prej vitit 2018, kur vetëm 29% e punonjësve të rinj ishin gra. Ky numër u rrit nga 34% punonjëse në vitin 2019, në 50% në vitin 2020, dhe 56% punonjëse në vitin 2021.

Në fund të vitit 2021, përbërja e personelit të gjithsejtë të DHSK-së dhe ZPS-së ishte 46% gra dhe 54% burra. Ky është një përmirësim i ndjeshëm krahasuar me vitin pararendës ku 38% ishin gra dhe 62% burra.

Brenda fundit të vitit 2021, DHSK-ja kishte arritur një përfaqësim gjinor disi më të balancuar në nivel sekretari dhe asistenti me përkatësisht 45% gra dhe 55% burra.

Në nivelet e drejtuesve dhe ekspertëve barazia gjinore është edhe më e lartë, me një dallim prej vetëm 2% midis grave (51%) dhe burrave (49%). Në nivel sekretari dhe asistenti, ZPS-ja ka 40% gra dhe 60% burra ndërsa në nivelin e drejtuesve dhe ekspertëve, 38% gra dhe 62% burra. Vlen të përmendet se në vitin 2021 u bë emërimi parë i një gruaje në postin e prokurores së lartë.

Në kuadër të përkushtimit të DHSK-së dhe ZPS-së për monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të bërë në fushën e barazisë gjinore, u mbledhën, analizuan dhe raportuan rregullisht të dhëna gjinore. Gjithashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore vazhdoi të kontribuonte për arritjen e një drejtpeshimi më të mirë gjinor, përmes përfshirjes së ndërgjegjësimit gjinor si një ndër kriteret kryesore në përshkrimet e vendeve të punës. Po ashtu, rritja e ndërgjegjësimit mbi njëanshmërinë e pavetëdijshme u trajtua në trajnimet e organizuara nga njësia për të gjithë anëtarët e paneleve të rekrutimit. U bënë gjithashtu përpjekje të mëtejshme dhe të fokusuar për përfshirjen e kandidateve femra në listat e kandidateve të përzgjedhur për intervistë.

2. | Personi i kontaktit për çështjet gjinore

Personi i kontaktit për çështje gjinore në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është shprehje e përkushtimit të përgjithshëm të drejtuesve të lartë për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një mjedisi pune gjithëpërfshirës në DHSK dhe ZPS.

Gjatë vitit 2021, personi i kontaktit për çështje gjinore organizoi një larmi aktivitete, midis të cilave dhe festimin në internet të Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Në javët që i paraprinë Ditës Ndërkombëtare të Gruas punonjësve iu dërguan disa artikuj frymëzues që flisnin për pengesat e kapërcyera nga gratë dhe punën e tyre të shkëlqyer në profesione tradicionalisht të mbizotëruara nga burrat.



Punonjësve iu shpërndanë maska mbrojtëse me mbishkrime në përkujtim të kësaj dite, duke vënë në pah përkushtimin e drejtuesve për një mjedis pune të larmishëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë. Së fundi, më 8 mars, disa punonjëse të DHSK-së dhe ZPS-së që punojnë në profesione të mbajtura tradicionalisht nga burrat, folën për përvojat e tyre të ngritjes në detyrë dhe zyrtarë të lartë të ZPS-së folën për përpjekjet e bëra për të siguruar një drejtpeshim më të mirë gjinor në disa seksione të institucionit.

Personi i kontaktit ndihmoi gjithashtu në organizimin e festimit në internet të Muajit të Krenarisë në qershor 2021, aktivitete që u shoqërua me një atmosferë muzikore të larmishme. Më tej, personi i kontaktit bashkërendoi punën me ZPS-në në kuadër


të masave të ndërmarra nga disa njësi për të siguruar më shumë balancë gjinore si dhe bashkërendoi punën me Njësinë e Burimeve Njerëzore për përditësimin e materialeve orientuese dhe të trajnimeve lidhur me rekrutimet, për të përfshirë informacion rreth përpjekjeve të drejtuesve për përfshirjen e perspektivës gjinore në DHSK dhe ZPS. Gjithashtu, personi i kontaktit për çështjet gjinore u kujdes për përditësimin e rregullt të faqes së internetit me artikuj interesantë dhe lidhje në internet për aktivitete mbi perspektivën gjinore në përgjithësi.

Po ashtu, personi i kontaktit për çështjet gjinore u ftua të fliste në disa aktivitete mbi përkushtimin e drejtuesve të lartë të DHSK-së dhe ZPO-së lidhur



me përfshirjen e perspektivës gjinore dhe përpjekjet e suksesshme të ndërmarra nga DHSK-ja dhe ZPS-ja në këtë drejtim. Gjatë gjithë vitit, personi i kontaktit për çështjet gjinore mbajti komunikim me personat e kontaktit në organizatat e tjera ndërkombëtare në Hagë për të shkëmbyer njohuritë dhe praktikatat më të mira lidhur me perspektivën gjinore.

Së fundi, personi i kontaktit për çështjet gjinore përfundoi me sukses një kurs 11-javor për këshilltarët gjinorë në misionet në kuadër të Politikave të Përbashkëta të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Bashkimit Evropian, organizuar nga Zyra e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil e Shërbimit të Jashtëm të Komisionit Evropian dhe Akademia Folke Bernadot.



Drejtuesit mbeten të përkushtuar në premtimin e tyre se DHSK-ja dhe ZPS-ja do të vazhdojnë të jenë mjedise pune të sigurta dhe gjithëpërfshirëse dhe se do të përmirësohen më tej në këtë drejtim. Që prej themelimit të tyre në vitin 2016, është treguar zero tolerancë ndaj çdo forme ngacmimi. Kjo sigurohet falë një sistemi politikash rigorozë që ndalojnë çdo formë diskriminimi, ngacmimi ose keqpërdorimi të detyrës dhe autoritetit, së bashku me një proces zyrtar për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave.

Po ashtu, perspektiva gjinore është ndërthurur edhe në politikat dhe procedurat ekzistuese. Për shembull, panelet apo komisionet me funksion këshillimor, si panelet e përzgjedhjes dhe rekrutimit dhe komisioni këshillimor disiplinor duhet të kenë përfaqësim gjinor të balancuar dhe leja për kujdesje prinderore mund të merret si nga gratë ashtu edhe nga burrat.

55%

NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI (DHSK)



MESHKUJ

49%

NIVEL DREJTUESI DHE EKSPERTI (DHSK)



MESHKUJ

60%

NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI (ZPS)



MESHKUJ

62%

NIVEL DREJTUESI DHE EKSPERTI (ZPS)



MESHKUJ

Zyra e Prokurorit të Specializuar



1 | Parathënie

Vitin e kaluar, fokusi i punës së ZPS-së u përqendrua më shumë në punën në sallën e gjyqit, me fillimin e dy gjykimeve, si dhe në përgatitjet intensive për të garantuar që edhe dy gjykimet e tjera të fillojnë sa më shpejt. Këto arritje nuk do të kishin qenë të mundura pa mbështetjen e shumë grave dhe burrave që kanë bashkëpunuar me hetimet tona në Kosovë e gjetkë, që na kanë dhënë dëshmi, na kanë rrëfyer historitë e tyre dhe të të dashurve të tyre dhe mbi të gjitha, kanë besim se ky institucion do të vendosë drejtësi. Tani ne duhet të sigurojmë që gjykata të hedhë dritë mbi krimet e kryera kundër tyre dhe që personat përgjegjës për ato krime të dalin para drejtësisë.

DHSK-ja dhe ZPS-ja u krijuan nga Kuvendi i Kosovës dhe janë dëshmi e përkushtimit të Kosovës ndaj sundimit të ligjit. Ato zbatojnë të drejtën ndërkombëtare - legjislacionin e zbatueshëm për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit – si pjesë e sistemit juridik të Kosovës, dhe rregullohen me ligj në Kushtetutën e Kosovës. Për këtë arsye puna jonë ofron mundësi: mundësi për Kosovën që t'i lërë pas çështjet e lidhura me luftën njëherë e përgjithmonë; mundësi për viktimat që t'u dëgjohet zëri në një mjedis ku mund të thonë të vërtetën pa u trembur nga hakmarrja apo frikësimi; dhe mundësi për të akuzuarit që akuzat kundër tyre të qartësohen publikisht dhe testohen fuqimisht nga avokatë mbrojtës të aftë.



Xhek Smith, Prokurori i Specializuar

Krahas personave që na kanë dhënë dëshmitë e tyre, dëshiroj të falënderoj të gjithë shtetet e Bashkimit Evropian dhe shtetet e treta kontribuese, Norvegjinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara, zemërgjerësi dhe përkushtimi i të cilëve ndaj sundimit të ligjit ka mundësuar punën tonë. Dëshiroj të falënderoj Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe shefin e Misionit, Lars-Gunar Uigemark, për mbështetjen kyçe logjistike dhe operative që i ofruan ZPS-së gjatë vitit të fundit. Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj punonjësit e tanishëm dhe të mëparshëm të ZPS-së, si edhe punonjësit e DHSK-së, në veçanti Kryetaren Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Dr. Fidelma Donlon, për përkushtimin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm, që kanë bërë të mundur të arrijmë këtu ku jemi sot.

Xhek Smith
Prokurori i Specializuar

Dhjetor, 2021

2 | Zbatimi i mandatit

Gjatë vitit 2021, ZPS-ja e vazhdoi punën në të gjitha frontet me gjithë vështirësitë e shkaktuara nga pandemia. Kështu, ZPS-ja bashkërendoi kryerjen e një arrestimi; hapi dy gjykime; u përfshi në debate juridike gjatë procedurave paraprake; i dorëzoi prova mbrojtjes në kuadër të procesit të nxjerrjes së provave; dhe kreu hetime të mëtejshme.

Më 16 mars 2021, autoritetet belge arrestuan Pjetër Shalën në Belgjikë në emër të ZPS-së dhe e mbajtën atë në paraburgim në bazë të urdhër-arrestit dhe aktakuzës së konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i DHSK-së.

Z. Shala u transferua në Hagë më 15 prill dhe paraqitja e parë publike e tij në sallën e gjyqit të DHSK-së u bë më 19 prill. Kundër tij janë ngritur katër akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme – të kryera ndaj personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999. Gjatë vitit 2021 u mbajtën katër konferenca për ecurinë e çështjes dhe ZPS-ja dorëzoi 52 parashtrime të protokolluara lidhur me çështjen kundër z. Shala.

ZPS-ja është përpjekur që gjykimet në të gjitha çështjet të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundshme pas hapjes së gjykimit në çështjen e Salih Mustafës më 15 shtator dhe gjykimit në çështjen e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt më 7 tetor.

Z. Mustafa përballet me katër akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme – mbi bazën e përgjegjësisë penale individuale dhe përgjegjësisë penale si eprror për krime të kryera nga disa anëtarë të UÇK-së ndaj personave të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash, Kosovë. Në vitin 2021, gjatë paraqitjes së provave të saj, ZPS-ja thirri dhjetë dëshmitarë për të dëshmuar në gjyq. Para fillimit të gjykimit, në vitin 2021 u mbajtën dy konferenca për ecurinë e çështjes dhe konferenca të procedurës paraprake. Në vitin 2021, ZPS-ja dorëzoi 90 parashtrime për protokollim në kuadër të kësaj çështjeje gjyqësore.

Z. Gucati dhe z. Haradinaj përballen me dy akuza për vepra penale kundër rendit publik – pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare - dhe katër akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike – frikësim gjatë procedurës penale; hakmarrje; dhe dy akuza për shkeljen e fshehtësisë së procedurës.



*Rreshti i parë nga e majta: prokurorët Met Holling, Valeria Bolici dhe Xhejms Paç
Rreshti i dytë: Zëvendësprokurori i Specializuar Aleks Uajiting*



Prokurori i Specializuar duke bërë deklaratën hyrëse në gjykimin Mustafa

Sipas aktakuzës së korigjuar, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, në tri konferenca për shtyp dhe ngjarje të tjera televizive si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan, pa autorizim, informacione të mbrojtura sipas Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ndër të cilat edhe të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm).

Deklarata hyrëse në gjykimin e Mustafës

Në deklaratën e tij hyrëse me fillimin e gjyimit të parë, atij të Salih Mustafës, në Dhomat e Specializuara, Prokurori i Specializuar Xhek Smith i përshkroi Dhomat e Specializuara të Kosovës si një gjykatë “e frymëzuar nga zërat kosovarë dhe e krijuar nga veprimet e popullit të Kosovës”, që është dëshmi e përkushtimit të Kosovës ndaj sundimit të ligjit.

Z. Smith theksoi se detyra e prokurorëve është që të sigurohet llogaridhënia individuale për krime që mund të vërtetohen jashtë dyshimit të arsyeshem dhe se përgjegjësia penale për krimet e gjykuara në Dhomat e Specializuara të Kosovës është individuale. “ZPS-ja nuk ngre akuza kundër UÇK-së apo kundër luftës që kreu ajo për pavarësinë e Kosovës. Kjo nuk është as detyra dhe as dëshira ime apo e ZPS-së,” tha Prokurori i Specializuar. “Është jashtë kompetencave të mia si prokuror të argumentoj apo të vendos se cilat luftëra ishin të drejta e cilat jo, por mund të them se krimet e luftës nga njëra palë nuk përligjin krimet e luftës nga pala tjetër,” shtoi z. Smith. “Ndoshta, dhe çka është edhe më e rëndësishme, jam gjithashtu i bindur se e vërteta asnjëherë nuk i dëmton kauzat e drejta.”

Prokurori i Specializuar e bëri të qartë mendimin e tij se kjo duhet të jetë një gjykatë që i kushtohet viktimave dhe është për viktimat. Ai theksoi se shumë viktima “janë detyruar të presin dy dhjetëvjeçarë për të kërkuar drejtësi për krimet e kryera kundër tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre që nuk janë më mes nesh,” dhe shpjegoi se: “Për t’u shërbyer ashtu si duhet këtyre viktimave, afati për llogaridhënien nuk duhet të përfundojë asnjëherë.”

Në lidhje me viktimat në çështjen kundër z. Mustafa, Prokurori i Specializuar theksoi se, ndërsa në çështjet e tjera gjyqësore të ngritura nga ZPS-ja viktimat ishin shqiptarë, serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera në Kosovë, viktimat e këtij të akuzuari ishin të gjithë shqiptarë të Kosovës. Prokurori i Specializuar tha: “Këta njerëz nuk ishin armiq të shtetit të Kosovës, nuk ishin spiunë. Ata ishin anëtarë të të njëjtit komunitet shqiptar të Kosovës, persona të pafajshëm, i vetmi krim i të cilëve ishte se për një arsye ose një tjetër konsideroheshin si pengesë për UÇK-në dhe për disa prej drejtuesve të saj, dhe për këtë u etiketuan si bashkëpunëtorë.

“E vërteta, që do të paraqitet para kësaj Gjykate në javët e ardhshme, është se disa drejtues të UÇK-së, përfshirë z. Mustafa, përdorën pushtetin e tyre për të viktimizuar dhe keqtrajtuar bashkëkombësit e tyre kosovarë, i vetmi krim i të cilëve ishte se pikëpamjet e tyre politike ndryshonin prej atyre të UÇK-së dhe drejtuesve të saj.”

Gjithashtu pretendohet se z. Gucati dhe z. Haradinaj bënë komente nënçmuese kundër dëshmitarëve (të mundshëm) dhe në mënyrë të përsëritur shprehën synimin e tyre për të dëmtuar punën e DHSK-së.

Gjatë paraqitjes së provave të saj, ZPS-ja thirri katër dëshmitarë. Në vitin 2021, përpara fillimit të gjyqimit, u mbajtën gjashtë konferenca për ecurinë e çështjes si dhe konferenca të procedurës paraprake. ZPS-ja dorëzoi 148 parashtrime të protokolluara lidhur me këtë çështje.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi përballen me gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë të personave – dhe me katër akuza për krime lufte – arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar; trajtim mizor; torturë dhe vrasje e paligjshme.

Sipas aktakuzës, krimet u kryen më së paku midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999 në disa vende në Kosovë, dhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipëri. Pretendohet se ato u kryen nga pjesëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Në aktakuzë pretendohet se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi mbajnë përgjegjësi penale individuale në bazë të formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krime që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

Në debatet juridike gjatë seancave të procedurës paraprake u trajtuan një numër aspektesh, si kërkesat e paraqitura nga të akuzuarit për rrëzimin e çështjes gjyqësore dhe nëse të akuzuarit duhet të mbahen në paraburgim në pritje të fillimit të gjyqimit. ZPS-ja i kundërshtoi me sukses kërkesat për lirim të përkohshëm, duke argumentuar në një varg parashtrimesh se ekzistonte rreziku real që, nëse liroheshin, të akuzuarit do të orvateshin të pengonin proceset e gjykatës dhe do të ndërhynin ndaj dëshmitarëve. Po kështu, ZPS-ja përmbushi sistematikisht detyrimin për nxjerrjen e provave, në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara. Gjatë vitit 2021, u mbajtën shtatë konferenca për ecurinë e çështjes dhe ZPS-ja dorëzoi 184 parashtrime lidhur me këtë çështje gjyqësore.

Raportime diplomatike dhe veprimtari informimi dhe ndërgjegjësimi

Gjatë vitit 2021, Prokurori i Specializuar Xhek Smith mbajti një numër takimesh diplomatike për të informuar shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese lidhur me punën e ZPS-së, vështirësitë me të cilat përballëj ZPS-ja dhe mënyrat se si komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmonte përshpejtimin e punës së ZPS-së.

Në mars, Prokurori i Specializuar Smith foli para Komitetit për Politika dhe Siguri të Bashkimit Evropian ndërsa në nëntor, Prokurori i Specializuar së bashku me Kryetaren e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Dr Fidelma Donlon, përmes videokonferencës nga Haga, raportuan dhe informuan diplomatët e shteteve anëtare dhe të shteteve të treta kontribuese. Mbështetja e komunitetit të gjerë ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet e rëndësishme për punën e ZPS-së.

Prokurori i Specializuar Xhek Smith dha intervistën e parë për shtyp në cilësinë e Prokurorit të Specializuar në shkurt 2021, për të përditshmen kosovare “Koha Ditore”. Gjithashtu, në qershor ai dhe Administratorja, Dr. Fidelma Donlon, përmes videokonferencës nga Haga, morën pjesë në një diskutim me përfaqësues të rrjetit informativ të gjykatës që përbëhet nga organizata joqeveritare nga Kosova dhe Serbia.



Prokurori i Specializuar duke dhënë dëshmi në gjykimin Gucati dhe Haradinajt

Gjatë gjithë vitit 2021, ZPS-ja vazhdoi thirrjen e dëshmitarëve, ndër të cilët ish-anëtarë të UÇK-së, për t'u paraqitur për intervistë në Hagë dhe në Prishtinë; kreu intervista me dëshmitarë; shqyrtoi të gjitha provat shkresore të mbledhura gjatë hetimeve dhe i përgatiti ato për t'ua bërë të njohura palëve; dhe punoi me autoritetet përgjegjëse në organizatat ndërkombëtare dhe shtetet për të marrë miratimin për përdorimin e tyre në gjykatë si dhe për të marrë miratimin për paraqitjen e dëshmitarëve në gjykatë.

Deklaratat hyrëse në gjykimin e Gucati dhe Haradinajt

Në fillim të gjyimit të Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, Prokurori i Specializuar Xhek Smith e përshkroi këtë çështje gjyqësore si një çështje që “ka të bëjë me kushtet që nevojiten për administrimin e drejtë të drejtësisë” dhe “çka nevojitet që sundimi i ligjit të bëhet realitet”.

Prokurori i Specializuar u shpreh se e vërteta është themeli i drejtësisë dhe se një e vërtetë që shpjegon arsyen për domosdoshmërinë e kryerjes së këtij gjykimi ishte se “ekziston një grup i vogël por i fuqishëm njerëzish në Kosovë që nuk dëshirojnë që kjo gjykatë të ekzistojë dhe të cilët do të bëjnë gjithçka për ta dëmtuar atë, në një orvatje të dështuar për të mbrojtur versionin e pavërtetë se asnjë ushtar i UÇK-së nuk ka kryer krime gjatë luftës.”

Z. Smith theksoi se z. Gucati dhe z. Haradinaj i përkasin këtij grupi dhe denigrojnë këdo që bashkëpunon me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në si “spionë”, “bashkëpunëtorë” dhe “tradhtarë” që kanë “tradhtuar” bashkatdhetarët e tyre. Prokurori i Specializuar theksoi se Dhomat e Specializuara duhet të jenë një gjykatë për viktimat dhe një nga arsyet për krijimin dhe vendosjen e saj në Hagë ishte “ekzistenca e atmosferës së frikësimit të dëshmitarëve dhe e ndërhyrjes në proceset gjyqësore kundër ish-anëtarëve të UÇK-së”.

“Në të shkuarën, kjo atmosferë arriti t'i pengonte dëshmitarët të vinin në gjykatë për të treguar çka dinin për krimet e UÇK-së,” tha z. Smith. “Të akuzuarit e njihnin mirë këtë histori dhe shpresuan se do të përdornin të njëjtën strategji edhe këtu për të frikësuar dëshmitarët, sepse ajo pati rezultat në të shkuarën.” Prokurori i Specializuar deklaroi se administrimi i drejtë i drejtësisë kërkon ngritjen dhe forcimin e institucioneve që mund të mbrojnë personat që kërkojnë drejtësi dhe se Dhomat e Specializuara kanë aftësinë të vendosin drejtësinë për shumë viktime në Kosovë.

“Arsyeja pse e kanë këtë aftësi është se Dhomat janë një vend i sigurt ku dëshmitarët mund të flasin hapur për krimet që kanë parë, krimet që i kanë vuajtur vetë dhe krimet prej të cilave kanë parë të vuajnë anëtarët e familjeve të tyre,” shtoi ai. “Çka është më e rëndësishme, ajo përfaqëson një vend ku ata mund të dëshmojnë pa pasur frikë nga hakmarrja dhe shpajimi.”

3 | ZPS-ja

ZPS-ja u krijua për të hetuar dhe, nëse do të ishte nevoja, për të ndjekur penalisht individë për krimet e pretenduara në Raportin e Këshillit të Evropës “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë” i janarit 2011.

ZPS-ja u krijua më 1 shtator 2016 në bazë të amendamentit kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja u krijuan pas kryerjes së një hetimi nga Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), dhe ZPS-ja trashëgoi personelin dhe mandatin e TFHS-së.

ZPS-ja është institucion i pavarur, pavarësia e së cilës garantohet nga Ligji që e krijoi atë. Rrjedhimisht, ZPS-ja ka detyrimin të veprojë në mënyrë të pavarur nga DHSK-ja dhe nga të gjithë prokurorët e tjerë në Kosovë. Gjithashtu, sipas ligjit, Prokurori i Specializuar dhe personeli i ZPS-së nuk kërkojnë e as nuk marrin udhëzime nga ndonjë qeveri apo burim tjetër.

Për çështje që lidhen me juridiksionin e tyre, Dhomat e Specializuara kanë përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. Dhomat e Specializuara ose ZPS-ja mund të urdhërojnë çdo prokuror apo

gjykatë tjetër në territorin e Kosovës që t'u transferojnë atyre të gjitha procedurat që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së dhe ZPS-së, në çfarëdo faze të hetimeve apo të proceseve gjyqësore.

Dejvid Shvendiman, ish prokuror federal i SHBA-së dhe më herët zëvendëskryeprokuror dhe shef i Departamentit Special për Krime Lufte në Bosnje dhe Hercegovinë, ishte i pari Prokuror i Specializuar që u emërua më 1 shtator 2016, kur TFHS-ja u shndërrua në ZPS. Xhek Smith u vendos në postin e Prokurorit të Specializuar në shtator 2018.



Dejvid Shvendiman, Prokurori i Specializuar i parë

Personeli

Personeli i ZPS-së përbëhet nga prokurorë, juristë, profesionistë në fushën e sigurisë, analistë, specialistë në fushën e sigurisë së dëshmitarëve dhe personel mbështetës. Në fund të vitit 2021, personeli i ZPS-së përbëhej nga punonjës me 20 shtetësi të ndryshme nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese.



4 | Kuadri udhëheqës i Prokurorisë

ZPS-ja drejtohet prej një ekipi prokurorësh të lartë, që të gjithë me mjaftë përvojë në juridiksionet e shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare.

Xhek Smith, prokuror amerikan me përvojë si në hetime politike të nivelit të lartë ashtu edhe në hetime penale ndërkombëtare, mori detyrën e Prokurorit të Specializuar në shtator 2018.

Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Smith ishte zëvendëskryetar dhe shef i seksionit të padive në Korporatën Spitalore të Amerikës, organizata më e madhe joqeveritare e shërbimit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara, post të cilin e mbante që prej shtatorit 2017.

Nga shkurti 2015 deri në gusht 2017, z. Smith ishte ndihmësprokurori i parë federal dhe ushtrues i detyrës së prokurorit federal për rajonin e mesëm në shtetin Tenësi.

Gjatë periudhës 2010-2015, z. Smith drejtoi seksionin për integritet publik në Departamentin e Drejtësisë të SHBA-së, ku ishte i ngarkuar me mbikëqyrjen e procedimit të çështjeve të ndërlikuara të korrupsionit publik në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

Nga viti 2008 deri më 2010, z. Smith ishte koordinator i hetimeve në Zyrën e Prokurorit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN). Në atë funksion ai mbikëqyri hetime delikate të zyrtarëve të qeverive dhe pjesëtarëve të forcave milicore të huaja për krime lufte, krime kundër njerëzimit, dhe gjenocid.

Përpara se të merrte detyrën në GJPN, z. Smith punoi në Zyrën e Prokurorit Federal për Rajonin Lindor të Nju Jorkut, ku gjatë nëntë viteve shërbeu në poste të ndryshme, përfshirë atë të shefit të zyrës për paditë penale dhe të zëvendëshefit të seksionit penal.



Xhek Smith, Prokuror i Specializuar

Si drejtues i zyrës për padi penale, z. Smith kishte në vartësi rreth 100 prokurorë penalë në një sërë fushash, ndër të cilat korrupsioni publik, terrorizmi, krimet e dhunshme dhe bandat, si edhe krimi ekonomik dhe mashtrimet financiare komplekse.

Përpara marrjes së detyrës së ndihmësprokurorit federal, z. Smith punoi për pesë vjet si ndihmësprokuror rajonal në Zyrën e Prokurorit të Kontesë së Nju Jorkut, ku shërbeu në seksionet e veprave penale seksuale dhe të dhunës në familje.

Gjatë karrierës së tij, z. Smith është nderuar me një sërë çmimesh, si Çmimi i Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së; Çmimi i Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA-së për Shërbime të Shquara; Çmimi i Shoqatës Federale të Juristëve për prokurorët e rinj federalë; Çmimi *Charles Rose* i Shoqatës së Rajonit Lindor; Medalja *Henry L. Stimson* e Shoqatës së Juristëve të Kontesë së Nju Jorkut; si dhe me bursën *Wasserstein* të Fakultetit Juridik të Universitetit të Harvardit.

Ai është diplomuar në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Oneonta.

Zëvendësprokurori i Specializuar është Aleks Uajting (Alex Whiting), prokuror me shtetësi franceze dhe amerikane, me përvojë të gjerë pune në fushën e ndjekjeve penale, si në juridiksione të brendshme, ashtu edhe ndërkombëtare, ku përfshihen periudha pune në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), si edhe me një karrierë të shquar akademike.

Z. Uajting, i diplomuar në Kolegjin dhe Fakultetin e Drejtësisë të Jeilit (Yale), erdhi në ZPS nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Harvardit, ku kishte punuar si profesor i praktikës juridike që prej vitit 2013.

Z. Uajting punoi në Zyrën e Prokurorit të GJPN-së nga 2010 deri në 2013, fillimisht si koordinatori i hetimeve, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve, dhe më pas si koordinatori i procedimeve, përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha procedimeve penale.

Në TPNJ, ku punoi nga 2002 në 2007, z. Uajting ishte kryeprokuror në gjykimin e Fatmir Limajt, Isak Musliut, dhe Haradin Balës, dhe kryeprokuror në gjykimet e Millan Martiqit dhe Dragomir Millosheviqit.




Aleks Uajting, Zëvendësprokurori i Specializuar

Përpara punës në TPNJ, z. Uajting ishte prokuror federal në SHBA, fillimisht në Seksionin Penal të Departamentit të të Drejtave Civile në Uashington dhe më pas në Zyrën e Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Boston, Masaçusets, ku u mor me çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

ZPS-ja ka dy prokurorë të lartë, Alan Tiger dhe Kler Loson. Alan Tiger (Alan Tieger) është Prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë në SHBA dhe në TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në çështjen e Dushko Tadiqit, edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në çështjen e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Biljana Pllavshiqit

Nga 1987 deri në 1994, z. Tiger ishte prokuror federal në Seksionin Penal të Drejtorisë së të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut (Rodney King).

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoraturës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin e Santa Klarës.



Alan Tiger, prokuror i lartë

Kler Loson (Claire Lawson), me shtetësi irlandeze, u diplomua në Kolegjin e Universitetit të Dublinit. Gjatë kohës së studimeve ajo kreu një vit specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin e magjistrit të drejtësisë në Universitetin e Kolumbias. Përpara se të fillonte punën në ZPS, z. Loson punoi si juriste në Seksionin Gjyqësor të GJPN-së, në Zyrën e Prokurorisë së TPNJ-së, si këshilltare për të drejtat e njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë të shquar avokatie në Irlandë.

Znj. Loson ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, ndër të cilat çështje që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian, dhe ish-Jugosllavinë. Ajo ka kryesuar gjithashtu negociata për të drejtat e njeriut në emër të BE-së dhe në OKB.



Kler Loson, prokurore e lartë

Drejtuesi i Njësisë së Hetimeve të ZPS-së është Vard Ferdinandys (Ward Ferdinandusse). Z. Ferdinandys, me shtetësi holandeze, përfundoi studimet universitare në drejtësi dhe mbrojti doktoraturën në Universitetin e Amsterdimit në fushën e zbatimit të së drejtës penale ndërkombëtare në gjykatat kombëtare. Ai ka botuar një numër të madh shkrimesh në lidhje me aspekte kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtës penale. Gjithashtu, ai ka dhënë mësim të drejtës penale ndërkombëtare dhe evropiane, me fokus mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjatë punës së tij si prokuror në Zyrën e Prokurorisë Publike në Rotterdam, z. Ferdinandys u angazhua në procedime penale, procedura ekstradimi dhe hetime të krimeve ndërkombëtare si gjenocidi, krimet e luftës, tortura, pirateria dhe terrorizmi. Para se t'i bashkohej ZPS-së, ai ishte kryeprokuror në gjykimin e çështjes lidhur me rrëzimin e avionit MH17.



Vard Ferdinandys, shëf i hetimeve

5 | Ekipet e Prokurorisë

Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Mustafës

Ekipi i prokurorisë në gjykimin e Salih Mustafës përbëhet nga Çezari Mihalçuk (Cezary Michalczuk), Silvia D'Askoli dhe Filipo De Miniçis. Z. Mihalçuk është prokuror polak, i arsimuar në Poloni dhe në Britaninë e Madhe, i cili, ndër të tjera, ka punuar si shef i Seksionit Juridik dhe Sundimit të Ligjit në zyrën e Përfaqësueses së Posaçme të BE-së në Kosovë në vitet 2015-2020, ndërsa në periudhën 2010-2015 ishte shef i Njësisë së Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Znj. D'Askoli është ndihmësprokurore italiane që ka

kryer doktoraturën në drejtësi, e specializuar në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. Në periudhën 2007-2016 punoi në TPNJ për ndjekjen penale të krimeve të luftës, ndër të tjera edhe në çështjen e Ratko Mladiqit. Z. De Miniçis është ndihmësprokuror italian që më parë ka punuar në TPNJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Korenë e Jugut.



Cezari Mihalçuk, prokuror



Silvia D'Askoli, ndihmësprokurore



Filipo De Miniçis, ndihmësprokuror

Ekipi i Prokurorisë në gjykimin e Gucatit dhe Haradinajt

Ekipi i prokurorisë në gjykimin e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt përbëhet nga Valeria Boliçi, Xhejms Paç dhe Met Holling. Znj. Boliçi është prokurore italiane e cila ka kryer doktoraturën në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare dhe para se t'i bashkohej ZPS-së ka punuar në TPNJ, si prokurore e EULEX-it në Kosovë, si dhe ka ndihmuar për përfaqësimin e Italisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Z. Paç është ndihmësprokuror maltez, i arsimuar në Maltë dhe Britaninë e Madhe, i cili më parë ka punuar në zyrën e prokurorisë në Gjykatën e Posaçme të Sierra Leones dhe në GJPN. Z. Holling është prokuror amerikan i miratuar për të ushtruar profesionin e avokatit në gjykatat e Kalifornisë. Ai iu bashkua ekipit të ZPS-së në vitin 2020, me leje të posaçme nga GJPN-ja, ku kishte punuar që prej vitit 2011.



Valeria Boliçi, prokurore



Xhejms Paç, ndihmësprokuror



Met Holling, prokuror



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS
RAPORTI I VITIT 2021**

Botuar dhe shpërndarë nga:

Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë:

Anglishte, shqipe, serbishte

**Për më shumë informacion, vizitoni faqen
e Internetit të DHSK-së:**

www.scp-ks.org

**Për pyetje nga mediat në lidhje me
Dhomat e Specializuara të Kosovës:**

mediaKSC@scp-ks.org

**Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën
e Prokurorit të Specializuar:**

spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike:

Wim Jansen Design

www.wimjansendesign.nl

Shtypur nga:

Quantes Grafimedia

www.quant.es.nl

E drejta e autorit- © 2022

**Dhomat e Specializuara dhe Zyra e
Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

A blue-tinted photograph of a desk. In the foreground, a black pen lies diagonally across a piece of paper. Behind it, a stack of several books is visible. To the right, a lamp with a glass globe is partially visible. The background is dark and out of focus.

www.scp-ks.org